

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Raporti i revizorit të pavarur dhe
Raportet financiare të përgatitura në pajtueshmëri me
Standardet Ndërkombëtare për Raportimin Financiar
për vitin që mbaron
më 31 dhjetor 2024**

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i revizorit të pavarur	1– 2
Bilanci i suksesit	4
Raporti për fitimin gjithpërfshirës	5
Raporti për gjendjen financiare	6 – 7
Raportet për ndryshimet e kapitalit	8 – 9
Raporti për flukset monetare	10
Shënime në raportet financiare	11 – 89

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në 2024

Anita Angellovska-Bezhoska, guvernatore
Fadil Bajrami, viceguvernator
Emilija Nacevska, viceguvernatore
Ana Mitreska, viceguvernatore
Sinisha Naumoski, anëtar joekzekutiv
Gadaf Rexhepi, anëtar joekzekutiv
Borçe Trenovski, anëtar joekzekutiv
Nikolla Popovski, anëtar joekzekutiv
Marjan Petreski, anëtar joekzekutiv

Selia

bul. "Kuzman Josifovski-Pitu", numër 1
1000, Shkup

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***BILANCI I SUKSESIT**

	Shënim	2024	2023
Të hyra nga interesi		5.022.026	2.984.237
Të dalat e interesit		(3.565.423)	(3.006.119)
Efekte nga interesi negativ		1.610	6.526
Neto-të hyra/të dala të interesit	5	1.458.213	(15.356)
Të hyra nga provizioni		566.572	480.188
Të dalat e provizionit		(19.644)	(18.517)
Të hyra neto nga provizioni	6	546.928	461.671
Kursi neto i perealizuar dhe ndryshimet e çmimeve	7	8.570.285	2.087.747
Të hyra neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit dhe instrumenteve financiare të derivateve	8	2.623.048	3.066.767
Të hyra neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës	9	127.841	46.873
Kursi neto i realizuar dhe ndryshimet e çmimeve	10	180.298	198.142
Të hyra nga dividendët	11	11.993	9.223
Të hyra të tjera	12	53.742	44.385
Të dala për puntorët	13	(677.174)	(571.035)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	27,28	(83.108)	(78.083)
Të dala të tjera	14	(231.746)	(248.179)
Ndarja e rezervës speciale dhe koriggjimi i vlerës, neto	15	(5.685)	(9.476)
Fitimi neto për vitin		12.574.635	4.992.679

RAPORT PËR FITIMIN GJITHPËRFSHIRËS

	Shënim	2024	2023
Neto fitimi për vitin nga bilanci i suksesit		12.574.635	4.992.679
Fitimi i mbetur gjithpërfshirës			
<i>Instrumente të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës</i>		<i>193.274</i>	<i>222.728</i>
Ndryshimet neto të çmimeve të parealizuara në vlerën objektive të letrave me vlerë të borxhit të matura me vlerën objektive përmes të hyrave të tjera gjithpërfshirëse	44	187.890	221.596
Humbja e pritshme kreditore e letrave me vlerë të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës, neto	15	6.756	1.132
Efektet e ndryshimeve të çmimeve të realizuara në letrat me vlerë të borxhit të matura me vlerën objektive përmes të hyrave të tjera gjithpërfshirëse	44	(1.372)	-
<i>Instrumente vetanake të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës</i>		<i>103</i>	<i>179</i>
Ndryshimet neto në vlerën objektive të letrave me vlerë të kapitalit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës	44	103	179
<i>Fitime nga librat e pranuar donacion - fondi i bibliotekës</i>		<i>10</i>	<i>42</i>
Totali i fitimit gjithpërfshirës të mbetur për vitin		193.387	222.949
Fitimi total gjithpërfshirës për vitin		12.768.022	5.215.628

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***RAPORT PËR GJENDJEN FINANCIARE**

MJETE	Shënim	31 dhjetor	
		2024	2023
Paratë e huaja efektive	16	685.130	821.607
Depozitat në valutë të huaj	17	58.174.088	107.859.919
Letra me vlerë të huaja	18	216.432.912	145.266.161
Instrumentet derivative	19	59.828	-
Ari	20	34.071.849	25.436.908
Të drejtat speciale të tërheqjes	21	71.116	13.249
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore	22	5.359.030	-
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	23	33.689.592	29.150.319
Anëtarësimi në FMN	24	10.606.363	10.528.522
Kreditë e dhëna te bankat	25	-	-
Kërkesa të tjera	26	-	-
Kërkesa nga bankat		-	-
Patundshmëri dhe pajisje	27	1.492.618	1.537.211
Mjetet jomateriale	28	33.588	46.721
Monedha nga metale të çmuara	29	7.594	6.082
Kërkesa nga operacionet	30	152.784	152.910
Mjete të tjera	31	197.321	115.449
Gjithsej mjete		361.033.813	320.935.058

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

RAPORT PËR GJENDJEN FINANCIARE (vazhdon)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënim	31 dhjetor	
		2024	2023
Paratë e gatshme në qarkullim	32	66.381.497	57.208.828
Depozitat e bankave dhe kursimoreve	33	96.729.753	93.207.011
Rezerva e detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	34	35.909.463	35.241.997
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	35	9.944.858	9.946.097
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	36	12.817.363	22.484.910
Depozitat në denarë të shtetit	37	27.751.870	25.796.921
Depozita valutore të shtetit	38	35.731.243	15.518.617
Depozitat e shtetit		63.483.113	41.315.538
Depozita të kufizuara	39	206.834	208.273
Detyrime në bazë të alokimit të DST-së – në emër dhe llogari të shtetit	40a	15.314.364	14.912.427
Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja, në emër dhe llogari të shtetit	40b	18.375.228	14.237.892
Detyrime në bazë të anëtarësimit dhe depozitave	40c	10.606.363	10.528.522
Detyrime ndaj FMN-së	40	44.295.955	39.678.841
Depozita të tjera	41	302.273	3.271.500
Rezerva speciale	42	65	373
Detyrime të tjera	43	3.486.610	765.425
Detyrime të tjera		3.486.675	765.798
Detyrimet totale		333.557.784	303.328.793
Kapitali		1.289.789	1.289.789
Rezerva të përgjithshme		1.200.434	688.977
Rezerva speciale		1.697.826	1.697.826
Rezervat e revalorizuara		23.287.980	13.929.673
Gjithsej kapitali dhe rezervat	44	27.476.029	17.606.265
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		361.033.813	320.935.058

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

RAPORT PËR NDRYSHIMET NË KAPITALIN									
	Shënim	Kapitali	Rezerva të përgjithshme	Rezerva speciale*	Rezervat e revalorizuara **	Rezervat e revalorizuara	Veprat artistike dhe fondi i bibliotekës	Fitimi/humbja e akumuluar	Gjithsej kapitali dhe rezervat
Gjendja më 1 janar 2023		1.289.789	432.826	843.987	9.929.227	502	4.085	-	12.500.416
Fitimi për vitin		-	-	-	-	-	-	4.992.679	4.992.679
Ndryshimet neto në vlerën objektive të letrave të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	221.596	-	-	221.596
Humbja e pritshme kreditore e letrave të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	1.132	-	-	1.132
Ndryshimet neto në vlerën objektive të letrave pronësore me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	179	-	-	179
Fitime nga donacionet e pranuar të librave - fondi i bibliotekës	44	-	-	-	-	-	42	-	42
Fitimi total gjithëpërfshirës për vitin 2023		-	-	-	-	222.907	42	4.992.679	5.215.628
Ndryshime neto të përealizuara pozitive dhe ndryshime çmimesh të arit	44	-	-	-	2.279.169	-	-	(2.279.169)	-
Neto diferencat e përealizuara negative të kursit	44	-	-	-	(79.669)	-	-	79.669	-
Ndryshimet neto pozitive të përealizuara të çmimeve nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	44	-	-	-	1.605.706	-	-	(1.605.706)	-
Ndryshimet e realizuara të çmimit të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	44	-	-	-	(32.296)	-	-	32.296	-
Shpërndarja në rezerva të përgjithshme	44	-	256.151	-	-	-	-	(256.151)	-
Shpërndarja në rezervat speciale me qëllim të veçantë	44	-	-	853.839	-	-	-	(853.839)	-
Shpërndarja në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	43	-	-	-	-	-	-	(109.779)	(109.779)
Gjendja më 31 dhjetor 2023		1.289.789	688.977	1.697.826	13.702.137	223.409	4.127	-	17.606.265

* Të definuara si rezerva speciale në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore të cilat ishin në fuqi për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2023 dhe 2024.

** Të definuara si llogari të rezervave të revalorizuara në Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (rezervat e revalorizuara për instrumente financiare të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit).

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

RAPORT PËR NDRYSHIMET NË KAPITALIN									
Rezervat e rivlersimit									
	Shënim	Kapitali	Rezerva të përgjithshme	Rezerva speciale*	Rezervat e revalorizuara **	Rezervat e revalorizuara	Veprat artisti -ke dhe fondi i bibliotekës	Fitimi/humbja e mbledhur	Gjithsej kapitali dhe rezervat
Gjendja më 1 janar 2024		1.289.789	688.977	1.697.826	13.702.137	223.409	4.127	-	17.606.265
Fitimi për vitin		-	-	-	-	-	-	12.574.635	12.574.635
Ndryshimet pozitive neto në vlerën objektive të letrave të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	187.890	-	-	187.890
Humbje e pritshme kreditore e letrave të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	6.756	-	-	6.756
Efektet e ndryshimeve të çmimeve të realizuara në letrat me vlerë të borxhit të matura me vlerën objektive përmes të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse	44	-	-	-	-	(1.372)	-	-	(1.372)
Ndryshimet neto në vlerën objektive të letrave pronësore me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	44	-	-	-	-	103	-	-	103
Fitime nga libra të pranuar, donacione- fondi i bibliotekës	44	-	-	-	-	-	10	-	10
Fitimi total gjithëpërfshirës për vitin 2024		-	-	-	-	193.377	10	12.574.635	12.768.022
Ndryshime neto të përealizuara pozitive dhe ndryshime të çmimit të arit	44	-	-	-	8.632.608	-	-	(8.632.608)	-
Diferencat neto të përealizuara nga kursi negativ i këmbimit	44	-	-	-	(62.323)	-	-	62.323	-
Ndryshimet neto pozitive të përealizuara të çmimeve nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	44	-	-	-	1.384.674	-	-	(1.384.674)	-
Ndryshimet pozitive të përealizuara të çmimeve nga instrumentet financiare derivative	44	-	-	-	59.828	-	-	(59.828)	-
Ndryshimet e realizuara të çmimit të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	44	-	-	-	(849.867)	-	-	849.867	-
Shpërndarja në rezerva të përgjithshme	44	-	511.457	-	-	-	-	(511.457)	-
Shpërndarja në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut	43	-	-	-	-	-	-	(2.898.258)	(2.898.258)
Gjendja më 31 dhjetor 2024		1.289.789	1.200.434	1.697.826	22.867.057	416.786	4.137	-	27.476.029

* Të definuara si rezerva speciale në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore të cilat ishin në fuqi për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2023 dhe 2024.

** Të definuara si llogari të rezervave të revalorizuara në Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (rezervat e revalorizuara për instrumente financiare të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit).

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Raportet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

RAPORT PËR FLUKSET MONETARE			
	Shënim	2024	2023
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi për vitin		12.574.635	4.992.679
I korigjuar për:			
Të hyra nga interesi	5	(5.022.026)	(2.984.237)
Të dala të interesit	5	3.565.423	3.006.119
Efekte nga interesi negativ	5	(1.610)	(6.526)
Ndryshime të parealizuara të kursit dhe çmimit nga ari		(8.632.608)	(2.279.169)
Të hyrat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit dhe instrumenteve financiare të derivateve		(4.363.497)	(1.510.900)
Të hyra neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithpërfshirëse	9	(127.841)	(46.873)
Të hyra nga dividendët	11	(11.993)	(9.223)
Korigjim i vlerës		6.121	9.246
Rezerva e veçantë e liruuar/e ndarë		(308)	29
Zhvlerësimi dhe amortizimi	27, 28	83.108	78.083
Flukset monetare të shfrytëzuara për/nga aktivitetet operative, para ndryshimeve në mjetet dhe detyrimet operative		(1.930.596)	1.249.228
Depozita me afat valutor mbi 90 ditë		(5.350.065)	-
Ari		-	(10.116)
Letra të huaja me vlerë dhe derivate të instrumenteve financiare		(66.064.443)	14.362.669
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore		(5.354.598)	8.902.551
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në		(4.139.263)	2.913.824
Mjete të mbetura		(102.603)	88.352
Paratë e gatshme në qarkullim		9.172.669	3.356.290
Depozita të bankave dhe kursimoreve		3.513.615	18.890.886
Rezerva e detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë		667.466	8.093.030
Bonot e thesarit të Bankës Popullore, të hyrat		78.772.070	86.699.296
Bonot e thesarit të Bankës Popullore, të dalat		(79.390.000)	(86.764.000)
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore		(9.662.306)	(4.874.586)
Depozita të shtetit duke përfshirë depozita të kufizuara dhe tjera		19.196.651	1.546.146
Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja në emër dhe llogari të shtetit		4.139.263	(2.913.824)
Detyrime të tjera		(48.820)	58.455
Interesi i pranuar		4.389.386	2.997.560
Interesi i paguar		(2.946.921)	(2.420.891)
Dividentët e pranuar		11.993	9.223
Neto rrjedhat monetare të përdorura për/nga aktivitetet operative		(55.126.502)	52.184.093
Furnizime të patundshmërive, pajisje dhe mjete jomateriale		(25.372)	(132.418)
Flukse monetare neto të përdorura në aktivitete investuese		(25.372)	(132.418)
Fitimi i paguar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut		(109.779)	-
Flukse monetare neto të përdorura për aktivitete financiare		(109.779)	-
Neto-ulje/rritje të parave dhe mjeteve monetare		(55.261.653)	52.051.675
Paratë dhe mjetet monetare në fillim të vitit		108.694.775	56.643.100
Paratë dhe mjetet monetare në fund të vitit	45	53.433.122	108.694.775

Shënimet prej faqes 11 deri te faqja 89 janë pjesë përbërëse nga këto raporte financiare

1. Informacione të përgjithshme

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) është bankë qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është institucioni i vetëm emetimi në shtet. Banka Popullore, si banka qendrore e emetimeve, është themeluar në vitin 1992. Organizimi dhe operimi i Bankës Popullore është i rregulluar me Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10 nga 9 dhjetori 2010, nr. 123/12 nga 2 tetori 2012, nr. 43/14 nga 4 marsi 2014, nr. 153/15 nga 4 shtatori 2015, nr. 6/16 nga 15 janari 2016, nr. 83/18 nga 8 maji 2018 dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 nga 19 maji 2021, nr. 74/24 nga 2 prilli 2024 dhe nr. 16/25 nga 24 janari 2025. Banka Popullore është person juridik me pavarësi administrative, financiare dhe udhëheqëse dhe është e autorizuar për arritjen e qëllimeve dhe për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj.

Sipas Ligjit të Bankës Popullore, qëllimi bazë i Bankës Popullore është arritja dhe mbajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëllimi tjetër, në varshmëri të qëllimit bazë, është të kontribuojë në mbajtjen e sistemit financiar të qëndrueshëm, konkurrues, dhe të orientuar nga tregu. Banka Popullore e mbështet edhe politikën ekonomike të përgjithshme pa rrezikuar arritjen e qëllimit parësor në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë.

Banka Popullore, në afat prej katër muajsh pas përfundimit të vitit financiar, publikon dhe parashton deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe deri te ministri i Financave, raporte, të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, në lidhje me gjendjet dhe lëvizjet në ekonominë për vitin që ka përfunduar dhe perspektivat për vitin e ardhshëm, me fokus të veçantë të arritjes së qëllimeve dhe politikave të Bankës Popullore, si dhe për gjendjen e sistemit bankar dhe për stabilitetin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në afat të njëjtë, deri te presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri te kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe deri te ministri i Financave, i dorëzon edhe raportet vjetore financiare për vitin financiar që ka përfunduar, të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, të nënshkruara nga guvernatori i Bankës Popullore dhe të rishikuara nga revizori i jashtëm i pavarur.

Kapitali i Bankës Popullore është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ai nuk mund të transferohet ose të jetë lëndë e çfarëdo qoftë ngarkese. Rezultati financiar¹ i Bankës Popullore vërtetohet në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF). Fitimi për alokimin ose humbjen për mbulim vërtetohet kur nga rezultati financiar i vërtetuar në pajtim me SNRF-në, të hyrat e parealizuara nga ndryshimet e kursit dhe të çmimeve do të barten në rezervat e revalorizuara, ndërsa shpenzimet e parealizuara nga ndryshimet e kursit dhe të çmimeve do të mbulohen nga rezervat e revalorizuara, të cilët shtohen të hyrat e realizuara dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të ndara rezerva të revalorizuara në vitet e mëparshme. Rezervat e revalorizuara të formuara nga të hyrat e parealizuara nga ndryshimet e kursit dhe të çmimeve, nga ku vlera e përgjithshme e rezervave të revalorizuara nuk mund të jetë më e ulët se zero.

¹ Në bilancin e suksesit "Fitimi neto për vitin".

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***1. Informacione të përgjithshme (vazhdon)**

Me ndryshimet e Ligjit të Bankës Popullore, që janë në fuqi që nga 24 janari 2025, rezervat speciale të Bankës Popullore u shfaqizuan², me detyrimin për transferimin e shumës së akumuluar në rezervat speciale në rezervat e përgjithshme³, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve, ndërsa ndryshim është bërë edhe në mënyrën e alokimit të fitimit për shpërndarje. Në pajtim me këtë aktvendim ligjor, nga fitimi për alokimin e rezervave të përgjithshme të Bankës Popullore akumulohen 30% deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë të përshkruar me Ligjin e Bankës Popullore, më sakt 15% nga rezervat e përgjithshme pas arritjes së nivelit të kapitalit bazë, ndërsa pjesa tjetër ndahet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Rezerva e përgjithshme përdoret për mbulimin e humbjeve të Bankës Popullore. Në rast se në vitin financiar vërtetohet humbje për mbulim, Këshilli i Bankës Popullore sjell vendim për mbulim të humbjeve nga rezervat e përgjithshme. Përderisa humbja është më e madhe se niveli i rezervës së përgjithshme, vlera mbi nivel mbulohet nga fitimi i viteve të ardhshme, nga ku ajo fillimisht shfrytëzohet për mbulim të humbjeve nga vitet paraprake në mbulimin e tyre të përgjithshëm, ndërsa më pas ndahet në pajtim me mënyrën e ndarjes së fitimit. Në rast kur kapitali i përgjithshëm⁴ i Bankës Popullore, i zvogëluar për humbjen e akumuluar të pambuluar nga viti i tanishëm dhe vitet paraprake, është më i vogël nga kapitali bazë i vërtetuar me Ligjin e Bankës Popullore, vlera e nevojshme për arritje të kapitalit mundësohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat jo më të gjatë se 60 ditë kalendarike nga kërkesa e Bankës Popullore, do të sigurojë shumën e nevojshme të mjeteve për mungesën e kapitalit në para të gatshme ose në letra me vlerë të transferueshme të borxhit me maturim të caktuar të emetuara sipas normave të interesit të tregut që mbizotërojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore të cilat ishin në fuqi për vitin i cili mbaroi më 31 dhjetor 2023, rezultati financiar për shpërndarje përcaktohej kur nga neto fitimi/humbja e përcaktuar në pajtim me SNRF-në zbritet shuma totale e të hyrave të parealizuar nga rivlerësimi dhe shtohet shuma e të hyrave të realizuar në vitin për të cilin janë ndarë rezervat e revalorizuar në periudhat e kaluara. Të dalat e parealizuar të rivlerësimit u mbuluan nga llogaritë përkatëse të rezervave të revalorizuar derisa gjendja e këtyre llogarive nuk u zvogëluar në zero, dhe më pas nga fitimi i realizuar në vitin aktual, nga llogaria e rezervës së përgjithshme dhe nga kapitali. Rezultati financiar për shpërndarje shpërndahet në rezervat e përgjithshme edhe në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe atë: 70% në rezervat e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë të përcaktuar me Ligjin e Bankës Popullore, gjegjësisht 15% në rezervat e përgjithshme deri në

² Rezerva speciale për mbulimin e shpenzimeve për qëllime të paracaktuara mund të krijohen me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore të vitit 2010. Me ndryshimet e Ligjit të Bankës Popullore nga janari 2016 u përcaktua mënyra e alokimit të një pjese të fitimit në rezervat speciale. Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 1.12.2015 dha pëlqimin për hapjen e "llogarisë rezervë speciale për të mbuluar shpenzimet për qëllime të paracaktuara", me qëllim të veçantë për ndërtimin e objektit të ri të Bankës Popullore. Në janar të vitit 2016, Këshilli i Bankës Popullore ka përcaktuar që niveli i llogarisë së rezervës speciale të arrijë shumën prej 2.200.000 mijë MKD, gjegjësisht shumën e vlerës së parashikuar të prokurimit për ndërtimin e objektit. Deri në fund të vitit 2023, me ndarjen e pjesës së përcaktuar me ligj të fitimit në rezerva speciale, janë akumuluar 1.697.826 mijë MKD.

³ Brenda afatit të përcaktuar me ligj, respektivisht më 7 shkurt 2025, rezerva speciale në shumën prej 1.697.826 mijë denarë u transferuan në rezervat e përgjithshme të Bankës Popullore, kështu niveli i rezervave të përgjithshme arriti 2.386.803 mijë MKD dhe ka tejkaluar shumën e kapitalit bazë të përcaktuar me Ligjin e Bankës Popullore.

⁴ Kapitali i përgjithshëm i Bankës Popullore paraqet shumën e kapitalit, rezervës së përgjithshme dhe rezervës së revalorizuar.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

arritjen e nivelit të kapitalit bazë, dhe pjesa tjetër për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në rastin e llogarisë së hapur të rezervës speciale, rezultati financiar për

1. Informacione të përgjithshme (vazhdon)

alokimin mund të shpërndahet deri në 70% në rezervë speciale deri në arritjen e shumës së përcaktuar nga Këshilli i Bankës Popullore, dhe pjesa e mbetur shpërndahet sipas mënyrës së alokimit të përshkruar më parë.

Organet e Bankës Popullore janë Këshilli i Bankës Popullore dhe Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore⁵. Këshilli i Bankës Popullore udhëheq me Bankën Popullore dhe përbëhet nga nëntë anëtarë nga të cilët guvernatori dhe tre viceguvernatorët me status të anëtarëve ekzekutiv dhe pesë anëtarë joekzekutiv. Guvernatori dhe tre viceguvernatorët e përbëjnë Këshillin Ekzekutiv të Bankës Popullore. Me Bankën Popullore udhëheq Këshilli i Bankës Popullore që është përgjegjës për definimin dhe formulimin e politikave dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe mbikëqyrjen e punës së Bankës Popullore. Këshilli Ekzekutiv është përgjegjës për zbatim të politikave. Guvernatori i Bankës Popullore kryeson me Këshillin e Bankës Popullore dhe me Këshillin Ekzekutiv, ka funksion kryesor ekzekutiv në Bankën Popullore dhe është përgjegjës për aktivitetin e saj të përditshëm.

Raportet financiare për vitin financiar 2024 janë miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 27 shkurt 2025.

dr. Anita Angellovska-Bezhoska,

guvernatore e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Vesna Filipovska,

drejtoresh në Drejtorinë e Financave, Kontabilitetit dhe Kontrollit

⁵Këshilli Ekzekutiv është themeluar si organ i Bankës Popullore në pajtim me ndryshimet në Ligjin e Bankës Popullore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 74/24 nga 2 prilli 2024).

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabiliste**

Politikat kryesore kontabiliste të zbatuara gjatë përgatitjes së këtyre raporteve financiare janë paraqitur më poshtë.

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare

Raportet financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF), standarde të kontabilitetit që janë të nxjerra nga ana e Këshillit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK), i cili përfshinë standardet dhe interpretimet e miratuara nga Këshilli i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare Financiare (KISNF).

Raportet financiare janë të përgatitura sipas parimit të vlerës blerëse si bazë për matje, përveç për mjetet e caktuara që maten sipas vlerës objektive. Mjetet që maten sipas vlerës objektive janë: mjetet financiare të vlerësuara sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit, mjeteve financiare të vlerësuara sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës, arit, derivateve financiare dhe veprave artistike. Pronat, pajisjet dhe mjetet jomateriale maten me çmimin e blerjes të zvogëluar për zhvlerësimin/amortizimin dhe humbjet për shkak të dëmtimeve, nëse ekzistojnë.

a) Ndryshime në mjedis

Në vitin 2024, normat e larta të inflacionit në nivel global të cilat paraqesin sfidë vitet e fundit filluan të kenë prirje për ulje⁶, që u mundësoi bankave qendrore të ekonomive kryesore të fillojnë ciklin e normalizimit të politikave monetare. Në këtë kontekst, BQE-ja⁷ dhe FED-i⁸ i ulën normat referente të interesit për 100 pikë bazike, nga ku BQE-ja e uli normën e interesit të depozitave për 3%, ndërsa niveli i përgjithshëm i FED-it në fund të vitit shënonte 4,25% – 4,5%. Pritshmëritë dhe ndryshimet në pozicionimin e politikës monetare kanë patur ndikim të madh mbi ndryshimet në tregjet ndërkombëtare financiare, nga ku normat e kthimit të instrumentet më të besueshme me të hyra fikse shënuan rënie në afatet e shkurtëra të maturimit. Nga ana tjetër, ecuria e favorshme e tregut të punës dhe e konsumit personal në ShBA ndikuan në perceptimet për ruajtjen e presioneve inflacioniste për një periudhë më të gjatë. Në një mjedis të tillë, normat e kthimit të obligacioneve qeveritare në ShBA të afateve më të gjata të maturimit, që në masë të madhe u bartën edhe në eurozonë, ku normat e kthimit të obligacioneve më të sigurta qeveritare u rritën me të njëjtin vëllim. Tensionet gjeopolitike në Ukrainë dhe Lindjen e Afërt edhe më tej paraqesin sfidë për investitorët, duke kontribuar në lëvizjet e herëpashershme të paqëndrueshme në tregjet ndërkombëtare.

⁶Në Eurozonë, norma e inflacionit në 2024 u reduktua prej 5,5% në 2,4% në mesatare, ndësa në ShBA prej 4,1% në 3%.

⁷Banka Qendrore Europiane (European Central Bank) – BQE.

⁸Sistemi Federal i Rezervave (Federal Reserve Bank of New York) – FED-i, është sistem i bankave qendrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)****A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)*****a) Ndryshime në mjedis (vazhdon)***

Kushtet në ekonominë vendase mundësuan që Banka Popullore nga shtatori 2024 të fillojë me normalizimin gradual të kushteve monetare me uljen e normave të interesit. Kështu, nga shtatori deri në dhjetor 2024 normat e interesit të kapitalit bazë të politikës monetare, bonot e thesarit, në tre raste radhazi janë ulur në total 0,75 p.p. nga 6,30% nga niveli prej 5,55%. Normat e interesit të depozitave njëditore dhe shtatëditore u ulën vetëm një herë në muajin dhjetor, për nga 0,25 p.p., nga 4,20% dhe 4,25% në nivelin prej 3,95% dhe 4,00%. Duke qenë se shuma e ofruar e bonove të thesarit u ruajt në nivelin prej 10.000.000 mijë MKD, bankat edhe këtë vit pjesën më të madhe të mjeteve të tepërta në denarë e orientuan drejt depozitave në dispozicion në Bankën Popullore, kryesisht me afat maturimi prej shtatë ditësh, bilanci mesatar i të cilit (rreth 48.500.000 mijë MKD) shënoi rritje vjetore. Bilanci mesatar më i lartë i depozitave bankare gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, mbajtja e normave të interesit në nivelin e fundit të vitit 2023 për një periudhë më të gjatë të vitit, d.m.th. deri në shtator 2024 dhe rënia e lehtë e tyre në fund të vitit, si dhe struktura e instrumenteve monetare, çuan në rritje të moderuar të shpenzimeve monetare në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023.

Në fillim të vitit u bënë ndryshime edhe te rezerva e detyruar. Ndryshimet janë bërë për të akumuluar një pjesë të likuiditetit të tepërt, por edhe për të stimuluar më tej kursimet afatgjata në denarë, duke thjeshtuar dhe modernizuar sistemin e rezervës së detyrueshme dhe duke e përafruar atë me strukturën e BQE-së. Kështu, norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet afatshkurtra në denarë të bankave u rrit gradualisht nga 5% në 8%, duke u normalizuar në nivelin e vitit 2022. Për të gjithë obligimet në valutë vendase me afat maturimi mbi 2 vjet, si dhe për obligimet e amvisërive të maturuara mbi 1 vjet zbatohet norma e rezervës së detyruar nga 0%. Gjithashtu, për detyrimet me maturim mbi 2 vjet në valutë të huaj, norma e rezervës së detyruar është rritur nga 0% në 5%, ndërsa për detyrimet afatshkurtra në valutë të huaj vazhdon të zbatohet një normë e rezervës së detyruar prej 21%. Norma e rezervës së detyrueshme prej 100% vazhdon të zbatohet për të gjitha detyrimet e bankave dhe kursimoreve me klauzolë valutore. Për të forcuar efektin e shkëputjes së normave nga aspekti valutor, përsëri u rrit pjesa e rezervës së detyruar në valutë të huaj e cila mbahet në euro, nga 81% në 85%, ndërsa detyrim më të madh në valutë të huaj u mundësoi bankave që në mënyrë më fleksibile të menaxhojnë me rritjen e pjesës që e plotësojnë mesatarisht, nga 10% në 15%.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**A Baza për përgatitjen e raporteve financiare (vazhdon)*****a) Ndryshime në mjedis (vazhdon)***

Të hyrat monetare në vitin 2024 u rritën në krahasim me vitin 2023, si rezultat i normave ende relativisht të larta të interesit dhe normave të kthimit të instrumenteve brenda rezervave valutore, në kushtet e normalizimit gradual të politikave monetare të BQE-së dhe bankave qendrore të ekonomive të tjera kryesore. Në të njëjtën kohë, u realizuan të hyra relativisht të larta të interesit nga vendosjet e llogarive të depozitave në bankat qendrore, si dhe të hyra relativisht të larta nga investimet në letrat e huaja me vlerë. Rritja e normave të kthimit të maturimeve afatmesme dhe afatgjata u pa si mundësi e favorshme për blerje të letrave me vlerë me kohëzgjatje më të gjatë të rregulluar, për të siguruar ecuri të favorshme në vitet në vijim. Gjithashtu, paqëndrueshmëria e përkohshme e normave të kthimit në tregjet e huaja lejoi qasje aktive ndaj menaxhimit dhe gjenerimit të të hyrave shtesë nëpërmjet shitjes së letrave me vlerë. Qasja aktive ndaj menaxhimit të rezervës valutore ka kontribuar në performancën më të mirë të portofolit të tregtimit në krahasim me portofolet referente përkatëse, e cila në masë të madhe ka ardhur si pasojë e zgjedhjes së instrumenteve, pra instrumenteve me norma të kthimit më të larta në të cilat janë investuar rezervat valutore.

b) Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja në standarde ekzistuese që janë në fuqi në periudhën raportuese:

Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e emetuara nga Këshilli i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë në fuqi në periudhën aktuale të raportimit janë:

- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e raporteve financiare"** - Ndryshimet në pjesën për klasifikimin e detyrimeve si rrjedhëse ose jorrrjedhëse, me të cilat sqarohen udhëzimet gjatë përcaktimit nëse një detyrim është rrjedhëse ose jorrrjedhëse (i zbatueshëm për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** - Ndryshimet në trajtimin kontabël gjatë matjes së njëpasnjëshme të detyrimeve të shitjes dhe qirasë kthyesë pas datës së transaksionit (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i raporteve financiare"** - Ndryshime në të cilën përmirësohet paraqitja e detyrimeve jorrrjedhëse me konventa në raportet financiare (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024); dhe
- **Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7 "Raporti i mjeteve monetare dhe instrumenteve financiare - zbulimet"** - Ndryshimet me të cilat përmirësohet paraqitja e kontratave financiare me furnizuesit dhe ndikimin e tyre mbi detyrimet, flukse monetare dhe ekspozimi i rrezikut të likuiditetit (të zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

A Baza për përgatitjen e raporteve financiare(vazhdon)

a) Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja në standarde ekzistuese që janë në fuqi në periudhën raportuese

Ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim material në raportet financiare të Bankës Popullore.

b) Standardet e reja dhe ndryshime në standarde ekzistuese që nuk kanë hyrë ende në fuqi

Në ditën e publikimit të këtyre raporteve financiare janë publikuar standardet në vijim, plotësimet dhe interpretimet e tyre të reja, të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi:

- **Ndryshimet në SNK 21 “Efektet nga ndryshimet e kurseve valutore”** - Ndryshimet me të cilat sqarohet qasja gjatë përgatitjes të raporteve financiare në rast të moskonvertueshmërisë afatgjatë ndërmjet valutave të caktuara gjatë paraqitjes së transaksioneve në valutë të huaj, kursimi, ose paraqitja e raporteve financiare në valutë tjetër (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025).
- **Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7 “Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare”** - Ndryshime që përmirësojnë fusha të caktuara të kontabilitetit në lidhje me shlyerjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare duke përdorur sistemin elektronik të pagesave dhe zbatimin e kërkesave për vlerësimin e flukseve monetare kontraktuale për aktivet financiare që lidhen me çështje të mjedisit, çështjet sociale dhe udhëheqësinë (e zbatueshme për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026); dhe
- **Përmirësimet vjetore të Standardeve SNRF – Vëllimi 11** – BSNK-ja përdor procesin e përmirësimeve vjetore për të bërë ndryshimet e nevojshme në standardet SNRF që nuk do të përfshihen si pjesë e ndonjë standardi tjetër. Ndryshimet do të pasqyrohen në standardet e mëposhtme: SNRF 1 në seksionin për zbatimin për herë të parë të kontabilitetit mbrojtës dhe SNRF 7 - në seksionin për çregjistrimin e fitimeve dhe humbjeve, dhënien e informacioneve shpjeguese të diferencave të shtyra midis vlerës objektive dhe çmimeve të transaksionit dhe prezantimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese rreth rrezikut të kredisë (e zbatueshme për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026).

Banka Popullore nuk i ka zbatuar këto standarde të reja dhe interpretime të reja para datës së zbatimit të tyre. Banka Popullore konsideron se pranimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve të reja nuk do të ketë ndikim material në raportet financiare të Bankës Popullore në periudhën e zbatimit fillestar të tyre.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)****B Transaksionet në valutë të huaj***Valuta funksionale dhe raportuese*

Artikujt që janë të përfshirë në raportet financiare janë paraqitur në valutën e mjedisit primar ekonomik në të cilën vepron Banka Popullore (valuta funksionale). Raportet financiare që janë paraqitur në denarë maqedonas (MKD), që është valuta funksionale dhe raportuese e Bankës Popullore, e shprehur në mijë denarë, përveçse nëse nuk është theksuar ndryshe.

Transaksionet dhe gjendjet

Mjetet dhe detyrimet të emërtuara në valutë të huaj paraqiten në MKD sipas kursit valutor në ditën e hartimit të Raportit për gjendjen financiare, përveç evidencës për kuotën e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin në FMN, si dhe si në llogaritë nr.1 dhe 2 (shënimi 24 dhe 40c). Transaksionet e kryera në valutë të huaj shprehen në MKD pas kursit valutor në ditën e transaksionit.

Të gjitha diferencat nga ndryshimet në kursin e këmbimit njihen në bilancin e suksesit.

Kursi mesatar i këmbimit:	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	MKD	MKD
USD	58,8807	55,6516
EUR	61,4950	61,4950
DST	76,5381	74,5293

C Netingu

Mjetet dhe detyrimet financiare janë neto dhe vlera neto e tyre paraqitet në Raportin e Pozicionit Financiar mbi bazën neto, nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga standardi i përshtatshëm për neto dhe mundësia e paraqitjes ose shlyerjes së transaksioneve në bazë neto.

Ç Transaksionet repo

Letrat me vlerë të shitura që janë lëndë e riblerjes (transaksionet repo) riklasifikohen në raportet financiare si mjete që jepen si garanci kur në bazë të kontratës, transferuesi ka të drejtë ose synon t'i shesë ose t'i lëjë peng ato si garanci. Detyrimet e bazuara në transaksione repo përfshihen në detyrimet e bazuara në transaksione repo në valutë. Të arkëtueshmet e bazuara në letrat me vlerë të blera që janë lëndë rishitjeje (transaksione të anasjellta të repove) përfshihen në të arkëtueshmet e bazuara në transaksione repo në valutë të huaj dhe kreditë e dhëna bankave.

Diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes përfaqëson interesin dhe llogaritet për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit. Nëse ka letra me vlerë që janë lëndë e huasë, në datën e raportimit paraqiten në raportet financiare.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**D Transaksionet repo (vazhdon)**

Letrat me vlerë që janë marrë hua dhe ato që merren si garanci për transaksionet e anasjellta të repove nuk njihen në raportet financiare, përveç rasteve kur u shiten palëve të treta, në këtë rast blerjet dhe shitjet paraqiten si fitim ose humbje dhe përfshihen në bilancin e suksesit në periudhën të cilës i referohen. Detyrimi për të kthyer letrat me vlerë paraqitet me vlerën objektive si detyrim nga operacionet e rregullta. Transaksionet repo paraqiten me harxhime të amortizuara, në rënie për korrigjimin e vlerës për humbjet e pritshme të kredisë (shiko shënimin 2I).

Transaksionet e arit të kolateralizuara trajtohen si marrëveshje riblerjeje. Detyrimet e bazuara në transaksionet e arit të kolateralizuara përfshihen në detyrimet e bazuara në transaksionet e repove në valutë. Ari që është lëndë e kësaj marrëveshjeje vazhdon të prezantohet në raportin për gjendjen financiare të Bankës Popullore dhe vazhdon me rregullimin e çmimit dhe kursit të tij. Diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes përfaqëson interesin dhe llogaritet për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit.

Dh Depozita në valutë të huaj

Depozita në valutë të huaj paraqiten me çmime të blerjes të amortizuara, të ulura për korrigjimin e vlerës për humbjet e pritshme të kredisë (shiko shënimin 2I).

E Ari monetar

Ari monetar përbëhet nga depozitat e arit në bankat korrespondente dhe stoku i shufrave të arit të prodhuara sipas standardeve ndërkombëtare që ruhen në thesarin e Bankës Popullore. Interesi për depozitat e arit paguhet në dollar amerikan apo në euro në datën e maturimit, në varësi të marrëveshjeve. Ari monetar është pjesë e rezervave valutore dhe menaxhohet në të njëjtën mënyrë si mjetet e tjera financiare nga rezervat valutore. Ari matet në njësinë matëse të onsit të imët të arit.

Ari monetar klasifikohet si mjet financiar me vlerën objektive përmes bilancit të suksesit, të përcaktuar si të tillë në njohjen fillestare dhe matet me vlerën objektive. Vlera objektive e arit monetar është e lidhur me çmimin e arit dhe llogaritet në bazë të çmimit të tregut para mesditës për 1 ons ari në bursën e arit në Londër, e shprehur në dollarë amerikanë, e shprehur në MKD me kursin aktual të këmbimit prej denarit maqedonas në kundërvlerë të dollarit amerikan në datën e raporteve financiare. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara nga rivlerësimi i arit në fund të periudhës kontabël që rezultojnë nga ndryshimet në çmimin e tregut të arit dhe ndryshimi i kursit të denarit në raport me dollarin amerikan, përfshihen në bilancin e suksesit. Interesi për arin monetar përfshihet në të hyrat nga interesi.

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**Ë Paratë dhe mjetet monetare**

Për qëllime të Raportit të flukseve monetare, paratë dhe mjetet monetare përfshijnë shuma me maturim më të vogël se 90 ditë nga data e blerjes, duke përfshirë depozitat në valutë të huaj, duke përjashtuar depozitat e kufizuara, valutën e huaj në thesarin e Bankës Popullore dhe mjetet me të drejta speciale të tërheqjes (në tekstin e mëtejshëm DST-ja⁹) në llogarinë speciale në FMN-në.

F Mjete financiare*Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare*

Banka Popullore i klasifikon mjetet financiare në tri kategori, dhe atë: mjetet financiare të matura me çmimin e blerjes të amortizuar, mjetet financiare të matura me vlerën objektive përmes të hyrave tjera përmbledhëse dhe mjetet financiare të matura me vlerën objektive përmes bilancit të suksesit. Banka Popullore përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në varësi të modelit të biznesit dhe flukseve monetare kontraktuale që priten prej tyre.

Modeli i biznesit përfaqëson mënyrë të menaxhimit të mjeteve financiare në mënyrë që të gjenerohen të hyra monetare ose të arrihet qëllim specifik i biznesit. Menaxhimi strategjik i Bankës Popullore përcakton modelin e biznesit në nivel të grupeve të mjeteve financiare që menaxhohen për të arritur qëllim specifik të biznesit.

Analiza e karakteristikave të flukseve monetare kontraktuale të mjeteve financiare zbatohet në nivelin e instrumenteve financiare individuale (kushtet kontraktuale) për të kontrolluar nëse flukset monetare kontraktuale nga mjetet lidhen ekskluzivisht me pagesën e "kryegjësë dhe interesit". Brenda flukseve monetare kontraktuale, elementi i "kryegjësë" përfshin shumën në miratimin fillestar, i minusuar prej çdo ripagesë; ndërsa elementi "interesi" përfaqëson kompensimin për vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, harxhimet administrative ose të shërbimit dhe marzhin e fitimit.

Banka Popullore menaxhon mjetet financiare përmes modeleve të mëposhtme të biznesit:

- Modeli i biznesit qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve me qëllim të mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale;
- Modeli i biznesit qëllimi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e mjeteve financiare; dhe
- Modele të tjera biznesi (tregtimi dhe realizimi i fitimeve nga ndryshimi i vlerës objektive të mjeteve).

⁹ Special Drawing Rights.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**G Mjete financiare(vazhdon)**

Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare (vazhdon)

Mjetet financiare të matura me vlerën furnizuese të amortizuar

Mjetet financiare të matura me çmimin e blerjes së amortizuar janë investime që synojnë të sigurojnë mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe nga të cilat Banka Popullore pret vetëm mbledhjen e "kryegjësë dhe interesit". Në këtë kategori përfshihen letrat me vlerë të të borxhit të matura me koston e amortizuar, kreditë dhe pretendimet me pagesa fikse ose të parashikuara që të cilat nuk janë të listuara në tregjet aktive.

Letrat e borxhit me vlerë të matura me shpenzimin e amortizuar, pas njohjes fillestare, të njëpasnjëshme paraqiten me shpenzimin e amortizuar reduktuar nga korrigjimi i vlerës për humbjen e pritshme të kredisë. Shpenzimi i amortizuar është e barabartë me shumën gjatë njohjes fillestare, reduktuar për shlyerjen e kryegjësë, në rritje ose në rënie për amortizimin kumulativ me përdorimin e metodës së normës efektive të interesit në të gjitha diferencat ndërmjet shumës fillestare dhe shumës gjatë maturimit.

Kreditë dhe të arkëtueshmet lindin nga aktivitetet ku Banka Popullore i jep para debitorit pa synimin e tregtimit. Kreditë njihen kur mjetet monetare i janë miratuar debitorit edhe janë paraqitur pas çmimit të blerjes së amortizuar me përdorimin e parimit të normës efektive të interesit. Paratë efektive të huaja, depozitat në valutë të huaj, të drejtat speciale të tërheqjes, kërkesat në bazë të transaksioneve repo, kërkesat nga shteti në raport me FMN-në, kërkesat nga bankat dhe kërkesat tjera janë të klasifikuara në këtë kategori të mjeteve financiare.

Për mjetet financiare të matura sipas vlerës së blerjes së amortizuar llogaritet humbja e pritshme e kredisë (shënimi 2I).

Letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës

Mjetet financiare të matura me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse janë investime me qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe/ose mbahen për shitje dhe sipas kushteve kontraktuale parashikojnë flukse monetare ekskluzivisht të "kryegjësë dhe interesit". Letrat me vlerë të kësaj kategorie njihen me vlerën objektive dhe ndryshimet në vlerën objektive paraqiten si komponent i veçantë i të hyrave të tjera përmbledhëse dhe njihen në kapital dhe rezerva, brenda llogarive për rezervat e revalorizuara. Pas tjetërsimit ose zvogëlimit të vlerës bazuar në njohjen e një provizioni për humbjen e pritshme të kredisë, fitimet dhe humbjet e akumuluarat të shprehura në të hyra të tjera gjithëpërfshirëse dhe të shpërndara në kapital dhe rezerva përfshihen në bilancin e suksesit për periudhën me të cilën ato lidhen.

Për mjetet financiare të matura sipas vlerës objektive përmes të hyrave tjera gjithëpërfshirëse llogaritet humbja e pritshme e kredisë (shënimi 2I).

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Gj Mjete financiare (vazhdon)

Klasifikimi dhe matja e mjeteve financiare (vazhdon)

Letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse (vazhdon)

Për investimet në instrumente pronësore të disa institucioneve financiare specifike, për të cilat nuk ka treg aktiv dhe zotërimi i të cilave përcaktohet me rregullore dhe/ose lidhet me mundësinë e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga këto institucione, mund të konsiderohet se vlera e tyre e blerjes pasqyron vlerën objektive të tyre. Për investimet në instrumente pronësore për të cilat nuk ka treg aktiv, por për të cilat mund të përcaktohet vlerë objektive, përcaktohet duke zbatuar teknikat e vlerësimit.

Mjetet financiare që maten sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit

Mjetet financiare që maten sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit janë investime për qëllime të tregtimit të tyre dhe realizimit të fitimeve nga ndryshimet në vlerën objektive të këtyre instrumenteve, si dhe investime në ato letra me vlerë që nuk i plotësojnë kriteret e dy kategorive të tjera. Këto letra me vlerë të borxhit dhe derivativët financiarë vlerësohen me vlerën objektive dhe ndryshimet në vlerën objektive përfshihen në bilancin e suksesit.

Njohja fillestare

Të gjitha mjetet financiare njihen fillimisht sipas çmimit të tyre të blerjes, respektivisht vlerës objektive të mjeteve të dhëna në momentin e blerjes së tyre, duke përfshirë të gjitha kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit me përjashtim të derivativëve financiarë dhe letrave me vlerë të matura me vlerën objektive përmes bilancit të suksesit dhe shpenzimeve për të cilat të gjitha shpenzimet njihen në bilancin e suksesit.

Riklasifikimi i mjeteve financiare të borxhit nga një kategori në tjetrën është i mundur vetëm nëse ka një ndryshim në modelin e biznesit për menaxhimin e mjeteve. Pritet që riklasifikimet do të përfaqësojnë raste të rralla dhe do të bëhen kur ndryshimi në modelin e biznesit ka një ndikim të rëndësishëm në operacionet e biznesit të Bankës Popullore, ose ndryshimi është për shkak të një ndryshimi të faktorëve të jashtëm ose të brendshëm që kanë një ndikim të rëndësishëm në aktivitetet e Bankës Popullore.

Çnjohja

Banka Popullore çnjeh aktivin financiar kur të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar ose kur aktivi financiar transferohet dhe transferimi kualifikohet për çnjohje. Banka Popullore çnjeh aktivin financiar, plotësisht ose pjesërisht, nëse nuk pret mbledhjen e kërkesave kontraktuale në tërësi ose pjesërisht.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**GJ Vlera objektive**

Për investimet në instrumentet financiare të tregtuara në tregjet financiare, vlera objektive përcaktohet nëpërmjet çmimeve të kuotuar në tregut. Për investimet e pakuotuar, vlera objektive përcaktohet nëpërmjet çmimeve të tregut të investimeve të ngjashme, ose bazohet në flukset monetare të pritshme të diskontuara.

H Korrigjimi i vlerës dhe mospagesa e mjeteve financiare

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për mjetet financiare të matura me shpenzimet e amortizuar dhe për mjetet financiare të borxhit që maten me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave tjera gjithpërfshirëse (depozita në bankat e huaja, letrat me vlerë të borxhit, të arkëtueshmet në bazë të transaksioneve repo, të arkëtueshmet, kreditë dhe paradhëniet) vlerësohet në baza të rregullta dhe shuma e humbjeve të pritshme të kredisë. Për investimet në instrumentet pronësore që maten me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera përmbledhëse, nuk llogaritet humbja e pritshme e kredisë.

Humbja e pritshme e kredisë përfaqëson shumë të barabartë me diferencën midis flukseve monetare kontraktuale të mjetit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme të mjetit financiar, të diskontuar duke zbatuar normën efektive të interesit të përcaktuar në njohjen fillestare të mjetit.

Në datën e raportimit për mjetet financiare, vlerësohet rreziku i kredisë, si dhe nëse ka pasur ndryshim të rëndësishëm në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e tyre. Bazuar në këto kritere, mjetet klasifikohen në një nga tre nivelet e rrezikut të kredisë. Për çdo mjet financiar të matur me çmimin e blerjes e amortizuar ose me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera përmbledhëse, përcaktohet shuma e korrigjimit të vlerës për humbjen e pritshme të kredisë, që korrespondon me nivelet e rrezikut të kredisë në të cilat klasifikohet mjeti.

Niveli 1: humbja e pritshme e kredisë – 12 muaj

Për mjetet financiare ku nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare dhe që në datën e raportimit kanë një rrezik të ulët kredie, njihet një humbje e pritshme kredie, e cila përfaqëson pjesë të humbjes për të gjithë jetëgjatësinë e mjeteve që do të ndodhte si rezultat i probabilitetit të shfaqjes së një ngjarje të padëshiruar brenda 12 muajve të ardhshëm.

Niveli 2: humbja e pritshme e kredisë për të gjithë jetëgjatësinë e mjetit - nuk ka dëshmi objektive të zhvlerësimit (humbje kredie)

Për mjetet financiare ku ka rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, por nuk janë të zhvlerësuar kreditë, njihet humbje e pritshme kreditore për të gjithë jetëgjatësinë e mjeteve.

Niveli 3: humbja e pritshme e kredisë për të gjithë jetëgjatësinë e mjetit - nuk ka dëshmi objektive të zhvlerësimit (humbje kredie).

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

I Zhvlerësimi dhe mospagesa e mjeteve financiare (vazhdon)

Mjetet financiare vlerësohen si të dëmtuara nga kredia si rezultat i ndodhjes së një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të mjeteve.

Konsiderohet se rreziku i mosrealizimit ndodh në rast vonese më të gjatë se 90 ditë dhe Banka Popullore i klasifikon ato mjete financiare në nivelin 3. Këto të arkëtueshme regjistrohen në llogaritë për të arkëtueshmet e dyshimta dhe të kontestuara. Zhvlerësimi njihet për të gjitha kërkesat e regjistruara në regjistrat kontabël që rezultojnë prej tij (kërkesa për: borxhin kryesor, interesin, gjobën e interesit, kërkesat e tjera dhe të ngjajshme).

Humbja e pritshme e kredisë llogaritet si produkt i ekspozimit të emetuesit/palës kontraktuese) në rast të mosplotësimit të detyrimeve, humbjes që do të ndodhë në rast mosplotësimit të detyrimeve dhe probabilitetit të mosplotësimit të detyrimeve, diskontuar me normën efektive të interesit të përcaktuar në njohjen fillestare. Probabiliteti për mosplotësimin varet nga vlerësimi mesatar i kredisë afatgjatë të instrumenteve: sa më i ulët të jetë vlerësimi i kredisë, aq më i lartë është probabiliteti për mospërmbushjen e detyrimeve.

J Kontabiliteti në datën e tregtimit dhe shlyerjes

Të gjitha blerjet dhe shitjet e rregullta të mjeteve financiare njihen në datën e shlyerjes, domethënë në datën në të cilën mjeti është marrë ose i është dorëzuar një personi tjetër. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerje ose shitje të mjeteve financiare që kërkojnë dorëzimin e mjeteve brenda një periudhe të caktuar, e cila kryesisht përcaktohet me anë të një kuadri ligjor ose konvente të tregut.

K Patundshmëri dhe pajisje

Të gjithë artikujt e pasurisë së paluajtshme dhe pajisjeve njihen sipas vlerës së tyre të blerjes të reduktuar zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

Toka, monedhat numizmatike dhe fondi i bibliotekës njihen sipas vlerës së tyre të blerjes dhe nuk janë subjekt i zhvlerësimit.

Pikturat e artit njihen me vlerën objektive dhe nuk janë subjekt i zhvlerësimit. Ndryshimet në vlerën objektive njihen në të hyrat e tjera përmbledhëse në rezervën e rivlerësimit për veprat e artit.

Investimet në vijim tregohen me çmimin e blerjes të përgatitjes së tyre duke përfshirë shpenzimet e palëve të treta. Nuk llogaritet zhvlerësimi gjatë investimit. Pas përfundimit të performancës, të gjitha kostot e akumuluar transferohen në patundshmëritë dhe pajisjet përkatëse dhe janë subjekt i normës së duhur të zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet nga shpenzimet e pasurive të paluajtshme dhe pajisjeve janë paraqitur në bilancin e suksesit.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)****L Patundshmëri dhe pajisje (vazhdon)**

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare, bazuar në jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pronave dhe pajisjeve, siç tregohet më poshtë:

	2024	2023
Objekte ndërtimore	5 deri më 50 vite	5 deri më 50 vite
Pajisje	2 deri më 10 vite	2 deri më 10 vite
Mjetet e transportit	5 deri më 6 vite	5 deri më 6 vite
Mobilje zyre	5 deri më 10 vite	5 deri më 10 vite

Jetëgjatësia e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe pajisjeve rishikohet dhe përshtatet së paku një herë në vit, ose nëse konsiderohet e nevojshme dhe zbatohet në mënyrë prospektive.

LL Mjetet jomateriale

Mjete jomateriale përbëhen nga programe kompjuterike dhe licenca. Mjetet paraqiten me çmimin e blerjes të reduktuar për amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ekzistojnë. Ato amortizohen sipas metodës lineare për jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar, e cila është nga dy deri në pesë vjet.

M Qiratë (mjete me të drejtën e përdorimit dhe detyrimet e qirasë)

Mjetet e së drejtës së përdorimit - mjetet e marra me qira fillimisht njihen me vlerën e tyre të blerjes në datën e fillimit të vlefshmërisë së marrëveshjes së qirasë, e cila është e barabartë me vlerën fillestare të detyrimeve të qirasë, e rritur nga pagesat e qirasë të bëra përpara ose në datën e fillimit të vlefshmërisë së marrëveshjes së qirasë dhe çdo harxhim që varet drejtpërdrejt nga marrëveshja e qirasë. Më pas, mjetet me të drejtën e përdorimit maten me vlerën kontabël fillestare minus zhvlerësimin / amortizimin dhe dëmin e akumuluar dhe përshtaten për rregullime të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimet e qirasë fillimisht njihen me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të qirasë, të diskontuara duke përdorur normën e qirasë kontraktuale. Nëse nuk është e përcaktuar në kontratë, përdoret normë rritëse, e cila përcaktohet në bazë të normës vjetore të interesit që mbizotëron në tregun e letrave me vlerë afatgjata të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, me maturim të barabartë ose më të afërt me periudhën e marrë me qira. Më pas, detyrimi i qirasë rritet për shpenzimet e interesit të qirasë, zvogëlohet për pagesat e bëra për detyrimin e qirasë dhe rregullohet kur rivlerësohet shuma që do të paguhej ose kur pagesat e ardhshme të qirasë ndryshojnë.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**N Qiratë (mjetet me të drejtë përdorimi dhëmjetet të marra me qira) (vazhdon)**

Për mjetet me të drejtë përdorimi (mjetet e marra me qira), amortizimi llogaritet duke zbatuar metodën lineare, bazuar në kohëzgjatjen kontraktuale të përdorimit të mjetit të marrë me qira, me efektet e njohura në bilancin e suksesit. Efektet e shpenzimeve të interesit mbi detyrimin e qirasë njihen në bilancin e suksesit, ku kostoja shpërndahet përgjatë gjithë afatit të qirasë.

Për mjetet e marra me qira, me afat përdorimi 12 muaj ose më pak dhe për qiratë me vlerë të ulët, pagesat e detyrimeve të qirasë njihen si kosto operative në bilancin e suksesit për kohëzgjatjen e qirasë.

Nj Humbje për shkak të dëmtimit të mjeteve jofinanciare

Mjetet që kanë jetë të pakufizuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe amortizimit dhe testohen për dëmtime në baza vjetore. Mjetet që janë subjekt i zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen në çdo datë raportimi me qëllim të përcaktohet nëse ekzistojnë dëshmi objektive të dëmtimit (të dëmtuara fizikisht, të vjetruara, të vjedhura, të humbura ose ngjarje të tjera që reduktojnë vlerën në përdorim të mjetit). Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla, vlerësohet vlera e rikuperueshme e mjeteve. Humbja për shkak të dëmtimit është e barabartë me shumën me të cilën vlera kontabël e mjetit tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Vlera e rikuperueshme është shuma më e madhe midis vlerës objektive të mjetit reduktuar për shpenzimet e shitjes dhe vlerës së mjetit në përdorim. Gjatë vlerësimit të dëmtimit të mjeteve, ato grupohen nga niveli më i ulët sipas aftësisë të krijojnë rrjedha monetare (njësi për krijimin e rrjedhës së parasë). Të gjitha mjetet jofinanciare, përveç gudvillit, për të cilat është njohur humbje nga dëmtimi, janë subjekt i analizës për të përcaktuar nëse ekziston mundësi për anulimin e humbjes nga dëmtimi në datën e raportimit.

O Monedha nga metale të çmuara

Monedhat e metaleve të çmuara përfshijnë monedhat përkujtimore dhe monedhat për qëllime koleksionimi.

Monedhat përkujtimore nuk janë mjet pagesor dhe zakonisht përmbajnë vlerë artistike ose kolektive dhe për rrjedhojë, shiten me çmim më të lartë se vlera e metalit nga i cili janë përpunuar. Banka Popullore prodhon monedha përkujtimore për të përkujtuar ngjarje të rëndësishme, bazuar në vendimin e Qeverisë. Monedhat përkujtimore vlerësohen me çmimin e tyre të shitjes, të miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore.

Monedhat për qëllime koleksioni janë mjete ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zakonisht përmbajnë vlerë artistike dhe koleksioniste. Monedhat për qëllime koleksionimi maten fillimisht me vlerën më të ulët nga vlera e tyre e blerjes dhe vlera e shtijes neto.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)**P Monedha nga metale të çmuara (vazhdon)**

Të hyrat nga shitja e monedhave të metaleve të çmuara njihen nëse ka mundësi që Banka Popullore të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen prej tyre dhe nëse ky përfitim mund të matet me besueshmëri.

Q Kartëmonedha dhe monedhat në qarkullim

Kartëmonedhat dhe monedhat në qarkullim të emetuara nga Banka Popullore paraqiten në Raportin e gjendjes financiare si detyrim në favor të mbajtësit, të shprehur në vlerë nominale. Kur kartëmonedhat dhe monedhat tërhiqen nga qarkullimi, detyrimi për paratë e depozituara rritet dhe zvogëlohet detyrimi në favor të bartësit për paratë e gatshme.

R Letrat me vlerë afatshkurtër

Letrat me vlerë afatshkurtër (bonot e thesarit) emetohen ekskluzivisht në valutë vendase në periudhë të maturimit prej 35/56 ditë. (2023: 28/49 ditë pune). Letrat me vlerë afatshkurtër (bono thesari), të emetuara nga Banka Popullore për arritjen e qëllimeve të politikës monetare, regjistrohen sipas vlerës së diskontuar, duke pasqyruar shumat që kanë paguar bankat dhe kursimoret për marrjen e tyre. Interesi llogaritet dhe regjistrohet sipas maturimit. Bonot e thesarit të Bankës Popullore fillimisht njihen me vlerën objektive dhe më pas maten me çmimin e blerjes së amortizuar.

Rr Depozitat

Depozitat pranohen fillimit sipas vlerës së tyre objektive. Depozitat maten rrjedhimisht sipas vlerës së tyre blerëse. Në depozitat përfshihen: depozitat e bankave dhe kursimoreve, depozitat e disponueshme të bankave dhe kursimoreve, rezerva e detyrueshme e bankave në valutë të huaj dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë, depozita tjera të bankave dhe kursimoreve, depozitat e shtetit, depozitat e kufizuara dhe depozitat tjera.

S Rezerva speciale

Rezervat speciale pranohen kur Banka Popullore ka detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, e cila është krijuar si rezultat i ngjarjeve të kaluara edhe për të cilën me shumë mundësi do të ndodh rrjedhje e mjeteve për të shlyer atë detyrim dhe ekziston mundësia për vlerësimin e shumës së detyrimit.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Sh Huamarrje

Huamarrja njihet në momentin kur ndodh, sipas vlerës objektive, neto nga shpenzimet e transaksionit. Rrjedhimisht pas njohjes fillestare, kreditë me interes maten sipas vlerës blerës të amortizuar. Nëse borxhi shlyhet para maturimit të tij, çdo diferencë mes shumës së paguar dhe vlerës kontabiliste shfaqet në bilancin e suksesit.

T Çregjistrimi i detyrimeve financiare

Banka Popullore i çregjistron detyrimet financiare kur detyrimet e përcaktuara në kontrata shlyhen, anulohen ose skadojnë.

Th Njohja e të hyrave dhe të dalave

Të hyra dhe të dala nga interesi

Të hyrat dhe të dalat nga interesi janë të shfaqura në bilancin e suksesit për të gjithë instrumentet e interesit, përveç për interesin nga letra me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, në bazë llogaritëse, me përdorimin e metodës së normës efektive të interesit.

Të hyra nga dividendët

Dividentët të cilët dalin nga investimet e pronësore të klasifikuara si mjete financiare të matura sipas vlerës objektive përmes fitimit të mbetur gjithëpërfshirës në bilancin e suksesit kur të përcaktohet e drejta për pranim të pagesës.

Provizione dhe të hyrat dhe të dalat e tjera

Të hyrat nga provizionet dhe tarifat dhe llojet tjera të të hyrave njihen me bazë llogaritëse.

Të dalat nga provizionet dhe tarifat dhe llojet tjera të shpenzimeve njihen me bazë llogaritëse.

Të hyrat/të dalat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit dhe instrumenteve financiare të derivateve

Të hyrat/të dalat neto nga letrat me vlerë të matura me vlerën objektive përmes fitimit ose humbjes përfshijnë interesin e përlllogaritur për letrat me vlerë të kuponit, fitimet dhe humbjet e realizuara që rezultojnë nga shitjet dhe ndryshimet e përealizuara pozitive dhe negative në vlerën objektive të letrave me vlerë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Fitimet dhe humbjet nga ndryshimi i vlerës objektive të transaksioneve me instrumente financiare të derivateve njihen në bilancin e suksesit.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

U. Njohja e të hyrave dhe të dalave (vazhdon)

Të hyrat/të dalat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës

Të hyrat/të dalat neto nga letrat me vlerë të matura me vlerën objektive përmes të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara që rezultojnë nga shitjet dhe njihen në pasqyrën e të hyrave. Ndryshimet e parealizuara në vlerën objektive të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës njihen në raportin për fitim gjithëpërfshirës.

V Ndryshimet e parealizuara të kursit dhe të çmimeve

Ndryshimet e parealizuara të kursit dhe çmimeve janë rezultat i harmonizimit të vlerës së mjeteve dhe detyrimeve të denominuara në valutë të huaj me vlerën e kursit të denarit dhe ndryshimet në çmimin e tregut në ditën e raportimit.

X Përfitimet e punonjësve

Kontribut për sigurimin pensional - plan për kontribute të definuara

Detyrime për kontributet e definuara për sigurim pensional në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut njihen si shpenzime në bilancin e suksesit për periudhën kur ndodh detyrimi.

Përfitime të tjera afatgjata për punonjësit

Përfitime të tjera afatgjata për punonjësit i përfshijnë pagesat e largimit në pension dhe e drejta e dhuratave jubilarë të punonjësve të cilët kanë punuar te punëdhënësi 10, 20, 30 gjegjësisht 40 vite. Këto përfitime janë në pajtim me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës dhe me Marrëveshjen kolektive të Bankës Popullore.

Detyrimi për përfitime afatgjata për punonjësit, përveç kontributeve të sigurimit pensional, është i njejtë me shumën e përfitimeve të ardhshme të cilat i realizojnë punonjësit në bazë të mundit të tyre në periudhat e tashme dhe të kaluara, i zbritur deri në vlerën aktuale duke zbatuar në normë interesi të ponderuar për obligacionet afatgjata të emetuara nga shteti në vitin financiar aktual.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

2. Rishikimi i politikave të rëndësishme kontabël (vazhdon)

Xh Tatimet

Në pajtim me rregulloret ligjore në fuqi për tatimin mbi fitim, Banka Popullore është e liruar nga tatimi mbi fitim.

Në pajtim me rregulloret ligjore në fuqi për tatimin mbi fitim, Banka Popullore është e liruar nga pagimi i tatimit mbi pronë.

Në pajtim me rregulloret ligjore në fuqi Banka Popullore është e obliguar të llogarisë tatimin e mbajtur të të hyrave për shërbimet e marra nga persona juridik të huaj.

Y Raportim sipas segmenteve

Aktivitetet e Bankës Popullore formojnë një segment operativ dhe realizohen në zonë gjeografike, Republika e Maqedonisë së Veriut. Banka Popullore ka shumë të konsiderueshme të mjeteve dhe detyrimeve financiare si pjesë të aktiviteteve të menaxhimit me rezervat valutore dhe operacionet e tregut vendas. Këto aktivitete nuk formojnë segmente të veçanta operative.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar

Raporti i gjendjes financiare të Bankës Popullore përbëhet nga instrumentet financiare. Këto instrumente e ekspozojnë Bankën Popullore ndaj rreziqeve financiare, përfshirë edhe rrezikun kreditor, rrezikun e tregut (rreziku nga dallimet e kursit dhe rreziku i normave të interesit) dhe rrezikut të likuiditetit.

A Rrezik kreditor

Rreziku kreditor është rrezik nga mos plotësimi i detyrimeve nga pala e kontraktuar, ulja e vlerës së mjeteve financiare si rezultat i uljes së rejtingut kreditor të institucionit financiar të kontraktuar ose bankës komerciale ku ruhen rezervat valutore dhe mjete të tjera financiare, ose të emetuesit të instrumentit në të cilin vendosen rezervat valutore, si dhe rreziku i rritjes së diferencës së normës së kthimit mes letrave më të sigurta shtetërore me vlerë dhe instrumentet tjera.

Mjetet valutore vendosen në instrumente të emetuara ose garantuara nga shtete ose subjekte shtetërore, qeveri rajonale ose lokale, institucione financiare ndërkombëtare dhe banka multilaterale të zhvillimit, banka afariste dhe institucione financiare, me rejting kreditor afatgjatë prej së paku BBB-/Baa3 ose të përshtatshëm, të caktuar nga agjencitë për rejting kreditor të njohura ndërkombëtarisht ("Standard dhe Purs", "Moody's" dhe/ose "Fitch"). Nëse vlerësimet për rejting kreditor dallojnë, përdoret rejting kompozitar (rejting i ponderuar mesatar).

Banka Popullore menaxhon me rrezikun kreditor nëpërmjet diversifikimit të investimeve. Lidhur me këtë, janë përcaktuar limite kuantitative për investimet sipas vendeve individuale dhe institucioneve financiare. Përkrah kësaj, caktohet edhe shuma maksimale e mjeteve të plasuara në lloje të letrave me vlerë¹⁰ edhe në emisionet individuale të letrave me vlerë.

Mbikëqyrja e ekspozimit të mjeteve valutore të rrezikut kreditor bëhet në bazë ditore.

Palët kontraktuese të Bankës Popullore janë të ndara në bazë të shkallës së rejtingut, e cila është e shprehur më poshtë. Qëllimi i shkallës së rejtingut është t'i klasifikojë palët kontraktuese dhe emetuesit e letrave me vlerë të borxhit (obligimet, letra tregtare, letra të skontos dhe certifikata depozite) sipas aftësisë kreditore. Aftësia kreditore e palëve kontraktuese dhe emetuesëve të obligimeve bazohet në rejting afatgjatë të përcaktuar nga agjencitë e rejtingut kreditor. Rejtinget kreditore afatgjata të bankave të huaja janë vlerësime dhe mendime për aftësinë e bankës për shlyerje të shpejtë të detyrimeve depozitare në valutë të huaj dhe/ose vendase. Rejtingjet kreditore të emetuesëve janë vlerësime dhe mendime për aftësinë e emetuesëve për plotësimin e detyrimeve dhe marrëveshjeve financiare.

¹⁰Për instrumentet më të sigurta përcaktohet shumë minimale e lejuar.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rrezik kreditor (vazhdon)**

Banka Popullore përcakton shumën e humbjes së pritur kreditore në bazë të probabilitetit të vlerësuar, si dallim mes flukseve monetare të cilat ndodhin sipas kushteve të marrëveshjes së instrumentit financiar dhe të flukseve monetare të cilat Banka Popullore pritët t'i paguajë. Banka Popullore përcakton shumën e humbjes së pritur kreditore të mjeteve financiare që maten sipas vlerës së amortizuar blerëse edhe për mjetet financiare që maten sipas vlerës objektive përmes fitimit gjithpërfshirës të mbetur.

Humbja e pritur kreditore matet sipas rrezikut për mospagesë, varësisht nga niveli i rrezikut kreditor dhe nëse rreziku kreditor i emetuesit / palës së kontraktuar është rritur konsiderueshëm nga njohja fillestare e ekspozimit. Zhvlerësimi i ekspozimeve me rejtingun investues kreditor dhe për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm (niveli 1) bazohet në probabilitetin e ndodhjes së një ngjarje të dëmshme për 12 muajt e ardhshëm. Zhvlerësimi për ato ekspozime që kanë pësuar rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor (niveli 2 dhe niveli 3) është në bazë të humbjes së pritur kreditore për tërë jetëgjatësinë e instrumentit. Konsiderohet se ka ndodhur rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor përderisa instrumenti, emetuesi ose pala kontraktuese kalon nga rejtingu kreditor investues, në jo investues. Instrumentet financiare rrjedhat monetare të të cilave vonohen prej 30 deri 90 ditë gjithashtu kalojnë në nivelin 2 dhe nivelin 3, përkatësisht, varësisht nga vonesa, përveç nëse vonesa nuk është për arsye operative.

Llogaritja e humbjes së pritur kreditore bëhet në bazë të ekspozimit ndaj emetuesit / palës kontraktuese, humbjes së vlerësuar në rast të mospërbushjes së detyrimit të kontraktuar dhe probabilitetit të mospërbushjes në periudhë të caktuar kohore, të përshtatur për skenaret e pritura makroekonomike. Njëkohësisht, përqindja e humbjes kushtëzohet nga prioriteti i kërkesës (prioritare ose subordinare) dhe probabiliteti i mospërbushjes vjen nga të dhënat historike për ndryshim të rejtingjeve kreditore, të cilat i publikojnë agjenci të njohura ndërkombëtare të rejtingut kreditor. Përshtatjet aplikohen në probabilitetin e mospërbushjes në bazë të regresit linear të treguesit për stabilitet të sistemit financiar, të matur nëpërmjet shkallës së kredive me probleme bankare, si koeficient i përshtatjes ekonomike të më shumë treguesëve makroekonomik.

Banka Popullore, në kuadër të menaxhimit me rrezikun kreditor në bazë mujore përcakton edhe vlerë të ekspozuar me rrezikun kreditor të rezervave valutore, e cila përfshin përlllogaritje të humbjes kreditore të pritur dhe të papritur (të llogaritur sipas udhëzimeve të Bazeli 3 për llogaritje të kapitalit ekonomik, gjegjësisht kapitalit për të mbuluar humbjen e papritur) për të gjitha instrumentet në kuadër të rezervave valutore.

Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rrezik kreditor (vazhdon)**

Shkalla krahasuese e rejtingut	Rejtingu kreditor afatgjatë
Vlerësim investues	AAA, AA+, AA, AA-, A+, A, A-, BBB+, BBB, BBB-
Vlerësim joinvestues	BB+, BB, BB-, B+, B, B-, ose më të ulët

Madhësia dhe ekspozimi i Bankës Popullore ndaj rrezikut kreditor paraqitet në Raportin për gjendjen financiare në shënimet për Raportin për gjendjen financiare të cilat i përshkruajnë mjetet financiare. Ekspozimi në bazë të rejtingut kreditor paraqitet sipas rejtingut mesatar kreditor të mjeteve financiare, të marrë nga vlerësimet e dhëna nga agjencitë e njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard dhe Purs", "Moody's" dhe/ose "Fitch". Kjo mënyrë e paraqitjes është e përshtatshme me qasjen në përcaktimin dhe mbikëqyrjen ditore të ekspozimit të rrezikut kreditor gjatë menaxhimit me rezervat valutore dhe është i përshkruar me Rregullat e udhëheqjes dhe investimit të rezervave valutore, të miratuara nga guvernatori.

MJETE	2024	2023
Depozitat në valutë të huaj	58.174.088	107.859.919
- Depozita valutore pa afat	17.199.550	76.758.735
- Depozita valutore me afat në banka të huaja	40.974.538	31.101.184
Letra me vlerë të huaja	216.432.912	145.266.161
Instrumentet derivative	59.828	-
Depozita të arit	34.009.820	25.390.596
Të drejtat speciale të tërheqjes	71.116	13.249
Kërkesa në bazë të transaksioneve repo valutore	5.359.030	-
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	33.689.592	29.150.319
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	171.197	159.823
Më 31 dhjetor	347.967.583	307.840.067

Analiza e strukturës së mjeteve financiare në Bankën Popullore tregon në pjesëmarrje të rritur të mjeteve të investuara në letra të huaja me vlerë në vitin 2024. Konkretisht, rritja e normave të kthimit të instrumenteve me të hyra fikse të maturimeve të mesme dhe të gjata u pa si një mundësi e favorshme për blerjen e letrave me vlerë me kohëzgjatje më të gjatë të rregulluar, për të siguruar ecuri të favorshme në vitet në vijim. Nga ana tjetër, ulja e tarifës për mbajtjen e mjeteve pranë bankave qendrore brenda Eurosistemit, në fund të vitit 2024, kufizoi mundësinë e gjenerimit të të hyrave të favorshme nga interesi nga depozitat pa afat në valutë në llogaritë rrjedhëse pranë bankave qendrore, kështu që shumica e këtyre fondeve të disponueshme u ridrejtuan gradualisht në letra me vlerë. Për qëllime të menaxhimit të kujdesshëm të likuiditetit, pjesë e mjeteve të disponueshme u vendosën edhe në depozita afatshkurtëra me afat pranë bankave qendrore dhe tregtare me vlerësime të larta krediti, ku pjesëmarrja e tyre në rezervat valutore gjithashtu u rrit në vitin 2024.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rrezik kreditor (vazhdon)**

Në tabelat në vijim shfaqet pasqyrë e mjeteve financiare me gjendje më 31 dhjetor 2024, gjegjësisht 31 dhjetor 2023, të cilat nuk janë maturuar dhe janë korigjuar për përmirësim të vlerës së humbjes së pritur kreditorë (për instrumentet e matura sipas vlerës së amortizuar blerëse), të analizuar sipas rejtingut kreditor mesatar të mjeteve financiare, të marrë nga vlerësimet e dhëna nga agjencitë e njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard dhe Purs", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

Mjetet financiare të korigjuara individualisht për zhvlerësimin më 31 dhjetor 2024, gjegjësisht 31 dhjetor 2023, shfaqen në kategoritë "Depozita valutore me afat në banka të huaja" (shënimi 17), "Letra me vlerë të huaj" (shënimi 18) dhe "Kërkesa nga puna dhe mjete të tjera" (shënimi 26 dhe shënimi 30). Zhvlerësimi i humbjes së pritur kreditorë për investimet në instrumente financiare lëviz në kornizat e nivelit 1, ku nuk ka lëvizje prej njërit në tjetrin nivel të ekspozimit të rrezikut. Kategoria "Kërkesa nga puna dhe mjetet e tjera" (shënimi 26 dhe shënimi 30) përfshin gjithashtu kërkesat për të cilat është bërë humbje e plotë nga zhvlerësimi dhe klasifikohen në nivelin 3.

Rejting 31 dhjetor 2024	Depozita në valuta pa afat	Depozita valutore të afatizuara në banka të huaja	Letra me vlerë të huaja	Instrume- ntet derivative	Depozita të arit	E drejta speciale e tërheqjes	Kërkesa në bazë të transaksio- neve repo devizore	Kërkesa nga shteti për marrëdhëni -et me FMN-në	Kërkesa nga puna dhe mjetet tjera	Gjithsej
AAA	697.879	8.048.463	81.712.204	36.970	-	-	-	-	-	90.495.516
AA+	22.445	1.277.862	40.568.361	-	-	-	-	-	-	41.868.668
AA	2.602	-	1.778.648	-	-	-	-	-	-	1.781.250
AA-	22.010	13.203.680	49.171.805	22.858	33.983.593	-	-	-	-	96.403.946
A+	6.199.154	922.577	3.172.167	-	-	-	-	-	-	10.293.898
A	10.908	17.521.956	11.967.678	-	-	-	5.359.030	-	-	34.859.572
A-	290	-	12.732.427	-	-	-	-	-	-	12.732.717
FMI ¹¹	10.713	-	44.106	-	26.227	71.116	-	-	-	152.162
BBB	10.233.549	-	15.285.516	-	-	-	-	-	-	25.519.065
BB ¹²	-	-	-	-	-	-	-	33.689.592	-	33.689.592
Të paranguara ¹³	-	-	-	-	-	-	-	-	171.197	171.197
Gjithsej	17.199.550	40.974.538	216.432.912	59.828	34.009.820	71.116	5.359.030	33.689.592	171.197	347.967.583

¹¹ Institucione financiare ndërkombëtare.¹² Rejtingu i Republikës së Maqedonisë së Veriut.¹³ Klientë në vende ku nuk kanë rejting kreditor sipas agjencive të njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard dhe Purs", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rrezik kreditor (vazhdon)**

Rejting 31 dhjetor 2023	Depozita valutore pa afat	Depozita valutore të afatizuara në banka të huaja	Letra me vlerë të huaja	Depozita të arit	Të drejta speciale të tërheqjes	Kërkesa nga shteti për marrëdhëni -et me FMN-në	Kërkesa nga puna dhe mjetet tjera	Gjithsej
AAA	43.550.707	1.537.870	47.247.774	-	-	-	-	92.336.351
AA+	10.488.061	-	28.439.647	-	-	-	-	38.927.708
AA	1.854.375	-	18.462.562	-	-	-	-	20.316.937
AA-	933.238	3.080.542	17.207.819	25.371.014	-	-	-	46.592.613
A+	4.143.574	-	2.128.850	-	-	-	-	6.272.424
A	8.120	26.482.772	5.362.029	-	-	-	-	31.852.921
A-	2.468.265	-	5.168.638	-	-	-	-	7.636.903
FMI ¹⁴	1.545.184	-	8.799.621	19.582	13.249	-	-	10.377.636
BBB+	-	-	2.177.930	-	-	-	-	2.177.930
BBB	11.767.211	-	9.649.473	-	-	-	-	21.416.684
BBB-	-	-	621.818	-	-	-	-	621.818
BB ¹⁵	-	-	-	-	-	29.150.319	-	29.150.319
Të paranguara ¹⁶	-	-	-	-	-	-	159.823	159.823
Gjithsej	76.758.735	31.101.184	145.266.161	25.390.596	13.249	29.150.319	159.823	307.840.067

¹⁴ Institucione financiare ndërkombëtare

¹⁵ Rejtingu i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹⁶ Klientë në vende ku nuk kanë rejting kreditor sipas agjencive të njohura ndërkombëtare për rejting kreditor "Standard dhe Purs", "Moody's" dhe/ose "Fitch".

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****A Rreziku kreditor (vazhdon)****Përqendrimi i rreziqeve të mjeteve financiare me ekspozim të rrezikut kreditor**

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin kreditor të mjeteve të Bankës Popullore sipas vlerës kontabël, të klasifikuar sipas rajoneve gjeografike më 31 dhjetor 2024. Për nevojat e kësaj table, Banka Popullore e klasifikon ekspozimin e rajoneve sipas vendit që vijnë palë kontraktuese:

	Vendet anëtare në BE	Vendet Europiane që nuk janë anëtare në BE	Republika e Maqedonisë së Veriut	Vendet anëtare tjera në OECD ¹⁷	Vendet tjera	Gjithsej
Depozita valutore pa afat	10.947.192	28.375	-	6.223.950	33	17.199.550
Depozita valutore me afat në banka të huaja	32.572.085	7.124.591	-	1.277.862	-	40.974.538
Letra me vlerë të huaja	195.732.622	1.432.817	-	18.031.860	1.235.613	216.432.912
Instrumentet derivative	-	59.828	-	-	-	59.828
Depozita të arit	-	23.247.629	-	10.762.191	-	34.009.820
Të drejtat speciale të tërheqjes	-	-	-	71.116	-	71.116
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore	5.359.030	-	-	-	-	5.359.030
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	-	-	33.689.592	-	-	33.689.592
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	171.197	-	-	171.197
31 dhjetor 2024	244.610.929	31.893.240	33.860.789	36.366.979	1.235.646	347.967.583
31 dhjetor 2023	210.924.060	25.575.552	29.310.142	37.467.472	4.562.841	307.840.067

¹⁷ Vendet e tjera anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) janë vende që nuk hyjnë në vendet anëtare të BE-së ose vendet europiane që nuk janë anëtare të BE-së.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**B Rreziku i tregut**

Banka Popullore ndjek dhe menaxhon edhe rrezikun valutor dhe të interesit, si rreziqe themelore të tregut. Qëllimi kryesor i Bankës Popullore gjatë menaxhimit me rreziqet e tregut është sqaruar në shënimin nr.1. Rreziku valutor paraqet rrezik nga ulja e vlerës së instrumenteve financiare në valutë të huaj shkaku ndryshimit të marrëdhënieve intervalutore të valutave. Rreziku i interesit paraqet rrezik nga ulja e vlerës së tregut të instrumenteve financiare shkaku i lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit. Menaxhimi me rrezikun e tregut bëhet me përcaktim të kohëzgjatjes së përshtatur për portofolet të cilat mbikëqyren në bazë ditore. Gjithashtu, rreziku tregut kontrollohet edhe përmes përcaktimit të buxhetit për rrezik, me të cilin definohet niveli i pranueshëm për rrezikun e interesit të rezervave valutore.

Për tu matur efekti i rreziqeve të tregut mbi vlerën e rezervave valutore, Banka Popullore zbaton konceptin e “vlerës së ekspozuar në rrezik” – VAR (ang. Value at Risk ose VAR). VAR-i paraqet metodologji statistike e cila e vlerëson ndryshimin maksimal të vlerës së rezervave valutore për shkak të ndryshimit të çmimeve të instrumenteve financiare dhe ndryshimi i kursit të këmbimit dhe me nivel të caktuar të besueshmërisë për një periudhë të caktuar kohore. Banka Popullore, gjatë llogaritjes së VAR-it, e përdor nivelin e besueshmërisë nga 95% për periudhë kohore një vjeçare¹⁸ dhe 99% për interval kohor prej dhjetë ditëve¹⁹.

Në dhjetor të vitit 2024, ekspozimi i rezervave valutore me të cilat menaxhon Banka Popullore (vlera e ekspozuar e rrezikut me nivel të besueshmërisë prej 99% për interval kohor prej dhjetë ditëve), për sa i përket fluksimeve të çmimeve të instrumenteve dhe kursit valutor të këmbimit ndaj euros shënon 2.839.925 mijë MKD (46.181.393 euro), ose 0,92 nga rezervat valutore. Në të njejtën kohë, VAR-i nga ndryshimi i kursit valutor të këmbimit për të njejtën periudhë (në bazë të diversifikuar, me ndryshim të përfshirë të çmimit të arit) shënon 2.477.926 mijë MKD (40.294.758 euro), ndërsa VAR-i, nga ndryshimet e çmimeve të instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore 361.999 mijë MKD (5.886.635 euro).

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rreziku valutor	2.477.926	1.562.849
Rreziku nga interesi	361.999	259.198
Gjithsej VAR-i	2.839.925	1.822.047

¹⁸ Për vlerësim intern të buxhetit të vendosur për rrezik.

¹⁹ Lidhur me rekomandimet nga marrëveshja e Bazelit e vitit 1999.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)

C Rreziku nga dallimet e kursit

Rreziku nga dallimet e kursit paraqet rrezik nga rënia e vlerës së mjeteve dhe detyrimeve financiare si rezultat i luhatjeve të kursit të këmbimit të valutave dhe çmimit të arit monetar.

Struktura valutore e rezervave valutore është e kushtëzuar nga struktura valutore e intervenimeve të mbështetjes së kursit të denarit ndaj euros, strukturës valutore të detyrimeve të Bankës Popullore dhe të shtetit ndaj vendeve të huaja, lloji i shkëmbimit të jashtëm tregtar dhe nga nevojat tjera likuide. Rrjedhimisht, euro është më e përfaqësuar në strukturën valutore të rezervave valutore. Ekspozimi i rrezikut valutor aktiv (që vjen nga devijimi nga struktura bazë valutore) është kufizuar me nivelin e rezervave të rivlersimit nga diferencat e kursit. Duke e pasur parasysh kursin fiks valutor "de fakto" të denarit ndaj euros, ekspozimi ndaj rrezikut valutor të Bankës Popullore ndaj euros është minimal, për dallim nga valutat tjera, ku ekspozimi është i pranishëm shkaku luhatjes së tyre ndaj euros, me atë edhe ndaj denarit.

Në tabelat më poshtë janë të përfshira mjetet dhe detyrimet financiare të Bankës Popullore sipas vlerës së tyre aktuale me gjendje të 31 dhjetorit 2024, gjegjësisht 31 dhjetor 2023, të analizuara sipas valutave.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****C Rreziku nga dallimet e kursit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2024:

MJETE	EUR	USD	DST	Valuta tjera	MKD	Gjithsej
Paratë e huaja efektive	395.629	271.353	-	18.148	-	685.130
Depozitat në valutë të huaj	49.116.116	1.308.164	-	7.749.808	-	58.174.088
Letra me vlerë të huaja	21.6391.773	-	41.139	-	-	216.432.912
Instrumentet derivative	59.828	-	-	-	-	59.828
Ari	-	34.071.849	-	-	-	34.071.849
E drejtat speciale e tërheqjes	-	-	71.116	-	-	71.116
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore	5.359.030	-	-	-	-	5.359.030
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	-	-	33.689.592	-	-	33.689.592
Anëtarësimi në FMN	-	-	10.606.363	-	-	10.606.363
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	10.747	1.799	85.137	13.035	60.479	171.197
Gjithsej mjete	271.333.123	35.653.165	44.493.347	7.780.991	60.479	359.321.105
DETYRIME						
Paratë e gatshme në qarkullim	-	-	-	-	66.381.497	66.381.497
Depozita të bankave dhe kursimoreve	11.416.755	-	-	-	85.312.998	96.729.753
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	35.899.043	-	-	-	10.420	35.909.463
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	-	-	-	9.944.858	9.944.858
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	9.044.293	-	-	3.773.070	-	12.817.363
Depozitat e shtetit	35.641.033	82.104	-	8.106	27.751.870	63.483.113
Depozita të kufizuara	141.217	65.617	-	-	-	206.834
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	44.295.955	-	-	44.295.955
Depozita të tjera	-	-	-	-	302.273	302.273
Detyrime të tjera	213.048	17.616	85.137	32.861	3.122.355	3.471.017
Detyrimet totale	92.355.389	165.337	44.381.092	3.814.037	192.826.271	333.542.126
Gjendja financiare neto	178.977.734	35.487.828	112.255	3.966.954	(192.765.792)	25.778.979

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****C Rreziku nga dallimet e kursit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2023:

MJETE	EUR	USD	DST	Valuta tjera	MKD	Gjithsej
Paratë e huaja efektive	531.678	270.410	-	19.519	-	821.607
Depozitat në valutë të huaj	100.308.997	1.858.164	-	5.692.758	-	107.859.919
Letra me vlerë të huaja	145.226.101	-	40.060	-	-	145.266.161
Ari	-	25.436.908	-	-	-	25.436.908
Të drejtat speciale të tërheqjes	-	-	13.249	-	-	13.249
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	-	-	29.150.319	-	-	29.150.319
Anëtarësimi në FMN	-	-	10.528.522	-	-	10.528.522
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	936	119	103.611	13.283	41.874	159.823
Gjithsej mjete	246.067.712	27.565.601	39.835.761	5.725.560	41.874	319.236.508
DETYRIME						
Paratë e gatshme në qarkullim	-	-	-	-	57.208.828	57.208.828
Depozita të bankave dhe kursimoreve	12.162.790	-	-	-	81.044.221	93.207.011
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	35.217.918	-	-	-	24.079	35.241.997
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	-	-	-	9.946.097	9.946.097
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	18.103.536	278.427	-	4.102.947	-	22.484.910
Depozitat e shtetit	15.481.745	26.788	-	10.084	25.796.921	41.315.538
Depozita të kufizuara	146.462	61.811	-	-	-	208.273
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	39.678.841	-	-	39.678.841
Depozita të tjera	-	-	-	-	3.271.500	3.271.500
Detyrime të tjera	281.215	16.735	103.611	33.465	317.247	752.273
Detyrimet totale	81.393.666	383.761	39.782.452	4.146.496	177.608.893	303.315.268
Gjendja financiare neto	164.674.046	27.181.840	53.309	1.579.064	(177.567.019)	15.921.240

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)

Ç Reziku i interesit

Banka Popullore është e ekspozuar ndaj rrezikut të interesit si rezultat i mospajtueshmërisë të strukturës së interesit të mjeteve dhe detyrimeve financiare.

Qëllimi kryesor i Bankës Popullore, arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, i jep të drejtë diskrete gjatë menaxhimit me politikën monetare që t'i përcaktojë normat e interesit të instrumenteve monetare. Por, nga ana tjetër, Banka Popullore është e ekspozuar në rrezik të interesit gjatë udhëheqjes me rrezervat valutore, ekskluzivisht për shkak të ndikimit të ndryshimeve të jashtme të tregjeve financiare.

Pozita e Bankës Popullore në raport të ndjeshmërisë së ndryshimeve të normave të interesit, e bazuar mbi momentin e përcaktimit të përsëritur të normës së interesit më 31 dhjetor 2024, gjegjësisht 31 dhjetor 2023, është e shfaqur në tabelat në vijim. Tabelat i përfshijnë instrumentet financiare të Bankës Popullore sipas vlerës së tyre aktuale, të karakterizuara sipas datës më të hershme nga data e rivlerësimit ose datës së maturimit.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****Ç Reziku i interesit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2024:

MJETE	Artikuj me interes					Gjithsej artikuj me interes	Artikuj pa interes	Gjithsej
	Deri 1 muaj ose norma variable	Prej 1 deri më 3 muaj	Prej 3 muaj deri më 1 vit	Prej 1 deri më 5 vjet	Mbi 5 vjet			
Para të huaja efektive	-	-	-	-	-	-	685.130	685.130
Depozitat në valutë të huaj	52.636.593	-	5.350.065	-	-	57.986.658	187.430	58.174.088
Letra me vlerë të huaja	-	4.450.040	141.435.595	27.356.480	3.604.048	176.846.163	39.586.749	216.432.912
Instrumentet derivative	-	-	-	-	-	-	59.828	59.828
Ari	-	18.447.463	-	-	-	18.447.463	15.624.386	34.071.849
Të drejtat speciale e tërheqjes	71.116	-	-	-	-	71.116	-	71.116
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore	5.354.598	-	-	-	-	5.354.598	4.432	5.359.030
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	-	-	-	-	-	-	33.689.592	33.689.592
Anëtarësimi në FMN	-	-	-	-	-	-	10.606.363	10.606.363
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	-	-	-	-	171.197	171.197
Gjithsej mjete	58.062.307	22.897.503	146.785.660	27.356.480	3.604.048	258.705.998	100.615.107	359.321.105
DETYRIME								
Paratë e gatshme në qarkullim	-	-	-	-	-	-	66.381.497	66.381.497
Depozita të bankave dhe kursimoreve	48.025.000	-	-	-	-	48.025.000	48.704.753	96.729.753
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	-	-	-	-	-	-	35.909.463	35.909.463
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	9.925.020	-	-	-	9.925.020	19.838	9.944.858
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	9.038.669	3.773.389	-	-	-	12.812.058	5.305.	12.817.363
Depozitat e shtetit	38.110.167	-	-	-	-	38.110.167	25.372.946	63.483.113
Depozita të kufizuara	-	-	-	-	-	-	206.834	206.834
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	-	-	-	-	44.295.955	44.295.955
Depozita të tjera	-	-	-	-	-	-	302.273	302.273
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	3.471.017	3.471.017
Detyrimet totale	95.173.836	13.698.409	-	-	-	108.872.245	224.669.881	333.542.126
Gjithsej rreziku i interesit	(37.111.529)	9.199.094	146.785.660	27.356.480	3.604.048	149.833.753	(124.054.774)	25.778.979

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****Ç Reziku i interesit (vazhdon)**

Gjendja më 31 dhjetor 2023:

MJETE	Artikuj me interes					Gjithsej artikuj me interes	Artikuj pa interes	Gjithsej
	Deri 1 muaj ose norma variabile	Prej 1 deri më 3 muaj	Prej 3 muaj deri më 1 vit	Prej 1 deri më 5 vjet	Mbi 5 vjet			
Paratë e huaja efektive	-	-	-	-	-	-	821.607	821.607
Depozitat në valutë të huaj	104.584.339	3.074.750	-	-	-	107.659.089	200.830	107.859.919
Letra me vlerë të huaja	123.090	1.046.057	84.009.453	39.497.571	312.714	124.988.885	20.277.276	145.266.161
Ari	-	2.295.523	3.457.908	-	-	5.753.431	19.683.477	25.436.908
Të drejtat speciale të tërheqjes	13.249	-	-	-	-	13.249	-	13.249
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	-	-	-	-	-	-	29.150.319	29.150.319
Anëtarësimi në FMN	-	-	-	-	-	-	10.528.522	10.528.522
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	-	-	-	-	-	-	159.823	159.823
Gjithsej mjete	104.720.678	6.416.330	87.467.361	39.497.571	312.714	238.414.654	80.821.854	319.236.508
DETYRIME								
Paratë e gatshme në qarkullim	-	-	-	-	-	-	57.208.828	57.208.828
Depozita të bankave dhe kursimoreve	61.519.000	-	-	-	-	61.519.000	31.688.011	93.207.011
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	-	-	-	-	-	-	35.241.997	35.241.997
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	9.927.040	-	-	-	9.927.040	19.057	9.946.097
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	21.312.817	1.161.547	-	-	-	22.474.364	10.546	22.484.910
Depozitat e shtetit	9.820.025	-	-	-	-	9.820.025	31.495.513	41.315.538
Depozita të kufizuara	-	-	-	-	-	-	208.273	208.273
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	-	-	-	-	39.678.841	39.678.841
Depozita të tjera	-	-	-	-	-	-	3.271.500	3.271.500
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	752.273	752.273
Detyrimet totale	92.651.842	11.088.587	-	-	-	103.740.429	199.574.839	303.315.268
Gjithsej rreziku i interesit	12.068.836	(4.672.257)	87.467.361	39.497.571	312.714	134.674.225	(118.752.985)	15.921.240

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**D Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rrezik nga mungesa e mjeteve likuide për zhvillim të papenguar të funksioneve të Bankës Popullore. Qëllimi kryesor i Bankës Popullore gjatë menaxhimit me rrezikun e likuiditetit është shpjeguar në shënimin 1.

Ruajtja e likuiditetit sigurohet me plasimin e mjeteve valutore në llogari rrjedhëse në vende të huaja, në depozita me afat të shkurtër dhe në letra me vlerë të borxhit për të cilat ekziston treg sekondar i thellë dhe likuid. Banka Popullore e menaxhon rrezikun e likuiditetit me përcaktimin dhe ruajtjen e mjeteve likuide në nivele përkatëse për zbatimin e politikës monetare dhe valutore, me kryerjen e pagesave të rregullta dhe në kohë të borxhit dhe shpenzimeve aktuale dhe/ose kapitale me komponentë valutore në llogari të shtetit, si dhe përmbushjen e nevojave transaksionare gjatë udhëheqjes me rezervat valutore. Në të njëjtën kohë, në pajtim me Politikën dhe Rregulloren për menaxhim dhe investim të rezervave valutore, udhëheqja me rrezikun likuidues është e përshtatur me praktikën më të mira globale. Rrjedhimisht, me qëllim që të optimizohet menaxhimi me rezervat valutore, në të njëjtën kohë duke i marrë parasysh detyrimet dhe qëllimet e ndryshme të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore, rezervat valutore janë të shpërndara në portofole të veçanta: kapital operativ (portofoli operativ), portofoli likuidues dhe investues.

Portofoli operativ siguron mjete likuide për realizimin e flukseve të parasë së gatshe në periudhë prej një muaji, ndërsa niveli i portofolit likuid përcaktohet në mënyrë dinamike, me shumë të nivelit minimal të portofolit operativ për 12 muajt e ardhshëm. Portofoli i investimeve mund të ketë periudhë të investimeve mbi një vit dhe ai menaxhohet me qëllim të rritjes së kthimit të rezervave valutore. Vlera e portofolit operativ dhe investues parashikohet së paku një herë në vjet, ndërsa periodikisht rishikohet bazuar në projeksionin e nevojave likuiduese, nevojave të pritura valutore të vendit në afat të mesëm dhe vlerësimin e cenueshmërisë së bilancit të pagesave. Afati maksimal i maturimit të depozitave dhe instrumentet e tregut të parasë të emetuara nga bankat tregtare në portofolin operativ është dy jave, ndërsa për letrat me vlerë të borxhit afati maksimal i mbetur deri në maturim është deri një muaj. Kohëzgjatja e përshtatur e portofolit likuidues është më e ulët krahasuar me portofolin investues dhe përcaktohet varësisht nga kushtet e tregut dhe nivelit të pranueshëm të rrezikut të interesit. Disponueshmëria e likuiditetit valutor nuk është e kufizuar në portofol operativ dhe likuidues, në kushte kur edhe investimi i letrave me vlerë të borxhit (të matura sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit dhe përmes fitimit të mbetur gjithpërfshirës) në kuadër të portofolit investues siguron likuiditet të mjaftueshëm nëpërmjet mundësisë së konvertimit të shpejtë të tyre të mjeteve monetare valutore.

Lidhur me detyrimet në valutë vendase, Banka Popullore nuk është e ekspozuar në këtë rrezik shkaku i karakterit të bankës qendrore.

Tabela e mëposhtme i paraqet të dalat monetare të Bankës Popullore të detyrimeve financiare joderivate dhe mjetet që ruhen për menaxhim me rrezikun e likuiditetit sipas maturimit të kontraktuar të mbetur në datën e Raportit të gjendjes financiare. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë rrjedhat monetare të paskontuara kontraktuale për detyrimet financiare dhe datat e pritura të maturimit të mjeteve financiare.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****D Rreziku i likuiditetit (vazhdon)**

31 dhjetor 2024	Deri 1 muaj	Prej 1 deri më 3 muaj	Prej 3 muaj deri më 1 vit	Prej 1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
DETYRIME						
Paratë e gatshme në qarkullim	66.381.497	-	-	-	-	66.381.497
Depozita të bankave dhe kursimoreve	67.418.903	-	29.310.850	-	-	96.729.753
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	-	-	35.909.463	-	-	35.909.463
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	-	9.944.858	-	-	-	9.944.858
Detyrime në bazë të transaksioneve repo						
valutore	12.817.363	-	-	-	-	12.817.363
Depozitat e shtetit	63.483.113	-	-	-	-	63.483.113
Depozita të kufizuara	174.536	26.311	5.987	-	-	206.834
Detyrime ndaj FMN-së	27.382.757	-	1.342.287	15.570.911	-	44.295.955
Depozita të tjera	302.273	-	-	-	-	302.273
Detyrime të tjera	529.844	2.898.258	42.915	-	-	3.471.017
Detyrimet totale						
(datat e maturimit kontraktual)	238.490.286	12.869.427	66.611.502	15.570.911	-	333.542.126
Mjete që ruhen për menaxhimin me rrezikun e likuiditetit (datat e maturimit të pritur)						
	280.094.002	22.909.921	9.476.769	43.127.049	3.713.364	359.321.105
31 dhjetor 2023	Deri 1 muaj	Prej 1 deri më 3 muaj	Prej 3 muaj deri më 1 vit	Prej 1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
DETYRIME						
Paratë e gatshme në qarkullim	57.208.828	-	-	-	-	57.208.828
Depozita të bankave dhe kursimoreve	75.950.413	-	17.256.598	-	-	93.207.011
Rezerva të detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	-	-	35.241.997	-	-	35.241.997
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	9.946.097	-	-	-	-	9.946.097
Detyrime në bazë të transaksioneve repo						
valutore	21.323.639	1.161.271	-	-	-	22.484.910
Depozitat e shtetit	41.315.538	-	-	-	-	41.315.538
Depozita të kufizuara	195.334	12.939	-	-	-	208.273
Detyrime ndaj FMN-së	26.869.676	-	3.921.173	8.887.992	-	39.678.841
Depozita të tjera	3.271.500	-	-	-	-	3.271.500
Detyrime të tjera	606.836	109.779	35.658	-	-	752.273
Detyrimet totale						
(datat e maturimit kontraktual)	236.687.861	1.283.989	56.455.426	8.887.992	-	303.315.268
Mjete që ruhen për menaxhimin me rrezikun e likuiditetit (datat e maturimit të pritur)						
	255.774.509	6.427.574	8.066.111	48.604.830	363.484	319.236.508

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****DH Vlera objektive e mjeteve dhe detyrimeve financiare**

Vlera objektive paraqet vlerë për të cilën një mjet mund të zëvendësohet (përfshirë edhe fitimin e tij të parave) ose ndonjë detyrim të shlyer nën kushte normale komerciale mes palëve të interesuara në datën e raportimit.

Dallimet mes vlerës kontabiliste dhe vlerës objektive të atyre mjeteve dhe detyrimeve financiare të cilat nuk janë të evidentuara sipas vlerës objektive të grupuara sipas klasave të instrumenteve financiare të shfaqura më poshtë:

	Vlera kontabiliste		Vlera objektive	
	2024	2023	2024	2023
Mjetet financiare				
<i><u>Të vlerësuara sipas vlerës së amortizuar blerëse</u></i>				
Paratë e huaja efektive	685.130	821.607	685.130	821.607
Depozitat në valutë të huaj	58.174.088	107.859.919	58.174.088	107.859.919
Letrat me vlerë të borxhit të huaja	43.819.381	41.900.906	43.182.268	40.479.751
Të drejtat speciale të tërheqjes	71.116	13.249	71.116	13.249
Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore	5.359.030	-	5.359.030	-
Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në	33.689.592	29.150.319	33.689.592	29.150.319
Anëtarësimi në FMN	10.606.363	10.528.522	10.606.363	10.528.522
Kërkesat nga puna dhe mjetet tjera	171.197	159.823	171.197	159.823
	152.575.897	190.434.345	151.938.784	189.013.190
<i><u>Të vlerësuara sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës</u></i>				
Letra me vlerë me pronësi të huaja	41.139	40.060	41.139	40.060
	41.139	40.060	41.139	40.060

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)****DH Vlera objektive e mjeteve dhe detyrimeve financiare (vazhdon)**

	Vlera kontabiliste		Vlera objektive	
	2024	2023	2024	2023
Detyrime financiare				
<i><u>Të vlerësuara sipas vlerës së amortizuar</u></i>				
<i><u>blerëse</u></i>				
Paratë e gatshme në qarkullim	66.381.497	57.208.828	66.381.497	57.208.828
Depozita të bankave dhe kursimoreve	96.729.753	93.207.011	96.729.753	93.207.011
Rezerva e detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë	35.909.463	35.241.997	35.909.463	35.241.997
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	9.944.858	9.946.097	9.944.858	9.946.097
Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore	12.817.363	22.484.910	12.817.363	22.484.910
Depozitat e shtetit në denarë	27.751.870	25.796.921	27.751.870	25.796.921
Depozita valutore të shtetit	35.731.243	15.518.617	35.731.243	15.518.617
Detyrime ndaj FMN-së	44.295.955	39.678.841	44.295.955	39.678.841
Depozita të mbetura dhe të kufizuara	509.107	3.479.773	509.107	3.479.773
Detyrime të tjera	3.471.017	752.273	3.471.017	752.273
	333.542.126	303.315.268	333.542.126	303.315.268

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**Dh Vlera objektive e mjeteve dhe detyrimeve financiare (vazhdon)****Mjetet financiare**

Vlera objektive e parave të gatshme të huaja, depozitave në valutë të huaj, Të drejtat speciale të tërheqjes, kërkesat në bazë të rapo transaksioneve valutore, anëtarësimi në FMN dhe të kërkesave të cilat vlerësohen sipas metodës së vlerës së amortizuar blerëse është e afërt me vlerën kontabël për shkak të karakterit të tyre afatshkurtër.

Vlera objektive e letrave me vlerë të huaja sipas vlerës së amortizuar blerëse përcaktohet në bazë të çmimit të tyre të kuotuar të tregut në datën e Raportit të gjendjes financiare.

Vlera objektive e letrave të huaja të borxhit të cilat maten sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës dhe i referohen aksioneve në BIS²⁰ nuk mund të përcaktohet realisht, për shkak se shfaqen sipas vlerës së tyre blerëse. Në këtë mënyrë llogaritet se vlera e tyre blerëse e rrefekton vlerën e tyre objektive.

Detyrime financiare

Vlera objektive e parave në qarkullim korrespondon me vlerën e tyre nominale.

Vlera objektive e depozitave të cilat vlerësohen sipas metodës së vlerës së amortizuar blerëse korrespondon me vlerën kontabiliste, për shkak faktit që nuk ekzistojnë instrumente me karakteristika të ngjajshme.

Vlera objektive e bonove të thesarit të emetuara nga Banka Popullore korrespondon me vlerën e tyre kontabiliste, për shkak të karakterit të tyre afatshkurtër.

Vlera objektive e detyrimeve në bazë të repo transaksioneve të cilat vlerësohen sipas metodës së vlerës së amortizuar blerëse korrespondon me vlerën kontabiliste, për shkak se ndiqet vlera objektive e kolateralit të dhënë dhe përkatësisht korrespondon me dhënien e letrave shtesë ose kthimin e letrave me vlerë ose me transferim të mjeteve monetare.

Për shkak të rolit specifik të FMN-së si institucion financiar ndërkombëtar, vlera objektive e detyrimeve në bazë të anëtarësimit të FMN-ja, ndarjen e të drejtave të veçanta të tërheqjes dhe detyrimeve në bazë të kredive të shfrytëzuara nga FMN-ja, nuk dallohen nga vlera e tyre kontabiliste.

²⁰Banka e Shlyerjeve Ndërkombëtare (Bank for International Settlements) – BIS.

3. Menaxhimi me rrezikun financiar (vazhdon)**DH Vlera objektive e mjeteve dhe detyrimeve financiare (vazhdon)****Hierarkia e vlerës objektive**

Vlera objektive përcaktohet në bazë të kësaj hierarkie:

a) Niveli 1 – Çmimi i kuotuar i tregut

Instrumente financiare me çmime të kuotuar të tregut për instrumente identike të tregut aktiv.

b) Niveli 2 – Teknika për vlerësim me përdorimin e informacioneve hyrëse (inpute) të cilat mund të mbikëqyren

Instrumentet financiare me çmime të kuotuar për instrumente të ngjashme të tregut aktiv ose çmime të kuotuar për instrumente të ngjashme ose identike për të cilat nuk ekziston treg aktiv dhe instrumente financiare të vlerësuara me përdorimin e modeleve ku mund të ndiqen të gjitha informacionet e rëndësishme hyrëse (inpute).

c) Niveli 3 – Teknika të vlerësimit me informacione të rëndësishme hyrëse (inpute) të cilat mund të ndiqen

Instrumente financiare të vlerësuara me përdorimin e modeleve ku nuk mund të mbikëqyren një ose më shumë informacione të rëndësishme hyrëse (inpute).

Mjete financiare të matura sipas vlerës objektive

31 dhjetor 2024	Niveli 1:	Niveli 2:	Niveli 3:	Gjithsej
Letrat me vlerë të borxhit të huaja	172.569.425	-	-	172.569.425
Ari	34.071.849	-	-	34.071.849
Instrumentet derivative	59.828	-	-	59.828
Letra me vlerë me pronësi të huaja	-	-	2.967	2.967
Gjithsej mjete financiare të matura sipas vlerës objektive	206.701.102	-	2.967	206.704.069

31 dhjetor 2023	Niveli 1:	Niveli 2:	Niveli 3:	Gjithsej
Letrat me vlerë të borxhit të huaja	103.322.332	-	-	103.322.332
Ari	25.436.908	-	-	25.436.908
Letra me vlerë me pronësi të huaja	-	-	2.863	2.863
Gjithsej mjete financiare të matura sipas vlerës objektive	128.759.240	-	2.863	128.762.103

4. Vlerësime të rëndësishme kontabël dhe arsyetimet gjatë zbatimit të politikave kontabël

Fushat më të rëndësishme për të cilat nevojiten arsyetime, vlerësime dhe supozime janë:

Vlera objektive e instrumenteve financiare

Banka Popullore përdor teknika interne të vlerësimit për përcaktimin e vlerës objektive të atyre instrumenteve financiare të cilat nuk kuotojnë në tregjet aktive. Këto teknika përfshijnë vlerësime dhe supozime të cilat pjesëmarrësit e tregut do t'i shfrytëzonin për përcaktimin e vlerës së instrumentit. Banka Popullore bën vlerësimin e vlerës në bazë të faktorëve të ndryshëm në dispozicion, përfshirë edhe çmimet dhe normat reale ose të vlerësuara të tregut, siç janë vlera kohore dhe paqëndrueshmëria, kushtet e tregut dhe likuiditeti. Vlerat e vlerësuara mund të dallohen nga vlera e cila do të arriheshte në transaksion në datën e matjes.

Banka Popullore zbaton modelet rregullisht nga një periudhë në tjetër, duke siguruar krahasueshmëri dhe kontinuitet në vlerësimet me kalimin e kohës, por vlerësimi i vlerës objektive përfshin edhe një shkallë të rëndësishme të arsyetimit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston përvojë, stabilitet dhe likuiditet mjaftueshëm në treg, për blerje dhe shitje të kërkesave dhe mjeteve tjera financiare ose detyrimeve për të cilat për momentin nuk janë të disponueshme çmimet e publikuara të tregut. Banka Popullore vlerëson ekspozimin e përgjithshëm të rrezikut edhe në raste kur vlerësohet se vlera në regjistrat nuk do të realizohet, pranohet ulja e vlerës. Sipas mendimit të Bankës Popullore, vlerat kontabiliste në datën e raportimit, për mjetet të cilat nuk kuotojnë në tregun aktiv e paraqesin vlerën më të saktë dhe më të dobishme të raportimit, duke i pasur parasysh kushtet aktuale të tregut (shënimi 3 Dh).

Afatshmëria e mjeteve materiale dhe jomatariale

Udhëheqësia e Bankës Popullore e përcakton jetëgjatësinë e vlerësuar dhe shpenzimet e lidhura për zhvlerësim dhe amortizim të mjeteve materiale dhe jomatariale. Përshtatshmëria e jetëgjatësisë së vlerësuar rishikohet një herë në vit ose kur ekzistojnë tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet bazë, siç janë zhvillimi i pritur teknologjik dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe industrial (shënimi 2J dhe 2K).

Supozimet aktuale lidhur me planin e dobive të definuara të punonjësve

Shpenzimet e mundshme të Bankës Popullore varen nga realizimi i përvojës së ardhshme dhe veçanarisht nga ndryshimi i normës së skontos dhe rritjes së pagesave. Faktorë tjerë të cilët mund ta ndryshojnë detyrimin total janë numri i punonjësve, largimi i parakohshëm para realizimit të drejtës së pensionit dhe numri i punonjësve të ri (shënimi 2U dhe 43).

4. Vlerësime të rëndësishme kontabël dhe arsyetimet gjatë zbatimit të politikave kontabël(vazhdon)

Zhvlerësimi për humbjen kreditore të pritur të mjeteve financiare

Banka Popullore llogarit humbjet e pritura kreditore të mjeteve financiare të matura sipas vlerës së amortizuar blerëse dhe për mjetet financiare sipas vlerës objektive përmes fitimit gjithpërfshirës të mbetur. Përcaktimi i të dhënave hyrëse në modelin e matjes së humbjeve të pritura kreditore janë të përshkruara në shënimin 3A.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***5. Neto-të hyra/të dala të interesit****Të hyrat nga interesi**

Të hyra nga interesi	2024	2023
<i>Subjekte të huaja</i>	<i>5.021.604</i>	<i>2.977.092</i>
Llogari rrjedhëse në valutë të huaj	1.741.650	1.448.879
Letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	1.435.409	302.357
Depozita me afat në valutë të huaj	1.024.455	633.828
Transaksionet repo e anasjellta në valutë të huaj me kolateral të pranuar në letra me vlerë	445.033	248.707
Letrat me vlerë të matura sipas vlerës së amortizuar blerëse	351.064	310.119
Depozita të arit	23.993	33.202
<i>Bankat vendase</i>	<i>378</i>	<i>77</i>
Interese tjera	378	77
<i>Shteti</i>	<i>42</i>	<i>78</i>
Interese tjera	42	78
<i>Subjekte tjera</i>	<i>2</i>	<i>6.990</i>
Interes ndëshkues nga shoqëritë private jofinanciare	2	6.990
Gjithsej	5.022.026	2.984.237

Rritja e të hyrave të interesit në vitin 2024 janë para se gjithash rezultat i normave të interesit akoma relativisht të lartë dhe normës së kthimi, si dhe të gjendjeve mesatare më të larta të instrumenteve në të cilat investohen mjetet valutore. Gjithashtu, të hyra të larta nga interesi u krijuan nga depozitat pa afat në valutë të huaj në llogaritë rrjedhëse në bankat qendrore të vendeve anëtare të eurozonës, nga investimet në letra me vlerë të matura me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera përmbledhëse dhe nga plasmanet në depozitat me afat në valutë pranë bankave të huaja.

Të dalat e interesit

Shpenzimet e interesit	2024	2023
<i>Bankat vendase dhe kursimoret</i>	<i>2.709.537</i>	<i>2.268.762</i>
Depozita në denarë	2.092.846	1.704.381
Bonot e thesarit të Bankës Popullore	616.691	560.222
Depozitat në valutë të huaj	-	4.159
<i>Subjekte të huaja</i>	<i>842.551</i>	<i>729.958</i>
Transaksionet repo klasike në valutë të huaj me kolateral të dhënë në letra me vlerë	842.551	729.958
<i>Shteti</i>	<i>13.048</i>	<i>7.356</i>
Depozita në denarë	10.323	6.247
Depozitat në valutë të huaj	2.725	1.109
<i>Subjekte tjera</i>	<i>287</i>	<i>43</i>
E drejta për interes për qira afatgjate	287	43
Gjithsej	3.565.423	3.006.119

5. Të hyrat/dalat neto nga interesi (vazhdon)**Të dalat e interesit (vazhdon)**

Të dalat më të larta të interesit në vitin 2024 janë rezultat i rritjes së tepricës mesatare të depozitave gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 dhe normave të interesit për instrumentet monetare.

Efekte nga interesi negativ

Efekte nga interesi negativ	2024	2023
<i>Subjekte të huaja</i>	<i>1.610</i>	<i>6.526</i>
Transaksionet repo klasike në valutë të huaj me kolateral të dhënë në ar	1.416	6.974
Transaksionet repo klasike në valutë të huaj me kolateral të dhënë në letra me vlerë	614	-
Llogari rrjedhëse në valutë të huaj	(420)	(448)
Gjithsej	1.610	6.526

6. Të hyrat neto nga provizionet**Të hyrat nga provizionet**

	2024	2023
Provizionet nga bankat vendase për qarkullimin e borxhit në llogari	344.188	297.682
Provizionet nga furnizimi i bankave me para të gatshme	90.119	62.662
Provizione në bazë të shlyerjes së pagesave (MIPS)	37.414	36.944
Provizione nga operacionet valutore me sektorin publik	26.600	26.602
Provizione në bazë të tarifave për lloje të ndryshme të pëlqimeve	24.149	17.679
Provizione të gatshme të kthyera nga bankat në thesar	20.488	17.292
Të hyra tjera të shërbimeve për kryerjen e qarkullimit të paguar në vend	20.391	18.403
Provizione tjera	3.223	2.924
Gjithsej	566.572	480.188

Provizionet që i paguan Banka Popullore janë të rregulluara me Vendimin për llojin dhe shumën e kompensimeve për shërbimet që i ofron Banka Popullore, si dhe me kontrata individuale të lidhura me organe shtetërore të caktuara.

Të hyrat në bazë të provizioneve për qarkullimin e borxhit në llogari, nga furnizimi i bankave me para të gatshme dhe me para të gatshme të kthyera në thesar, si dhe shlyerjen e pagesave nëpërmjet MIPS-it²¹ iu referohen shërbimeve të cilat Banka Popullore i kryen për bankat vendase dhe për bartësit e tjerë të llogarive në MIPS.

²¹MIPS – Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë, pronësi e Bankës Popullore.

6. Të hyrat neto nga provizionet (vazhdon)**Të hyrat nga provizionet (vazhdon)**

Provizionet nga operacionet valutore me sektorin publik i referohen të hyrave të realizuara nga shitja e valutës tek organet shtetërore, si dhe nga kryerja e punës për shtetin në qarkullimin pagesor jashtë vendit.

Shpenzime nga provizionet

	2024	2023
Provizione për depozituesit e letrave me vlerë	11.351	9.868
Provizione për shërbime nga bankat e huaja	7.599	8.471
Provizione tjera	694	178
Gjithsej	19.644	18.517

Provizione të paguara bankave të huaja iu referohen shërbimeve të mbajtjes së llogarive të Bankës Popullore, transaksioneve të realizuara me depozitat e Bankës Popullore, transaksione të realizuara me marrëveshjet e së ardhmes dhe transaksione tjera në valutë të huaj dhe ato varen nga tarifat e bankave të huaja dhe llojit të shërbimeve.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve për provizione iu referohen shpenzimeve për operacione me letrat me vlerë të cilat Banka Popullore ia paguan depozituesëve dhe bankave të huaja dhe të shpenzimeve për shërbime nga bankat e huaja.

7. Kursi neto i parealizuar dhe ndryshimet e çmimeve

	2024	2023
Diferencat e parealizuara pozitive të kursit	4.792.298	6.765.750
Diferencat e parealizuara negative të kursit	(4.854.621)	(6.845.419)
Diferencat e parealizuara negative të kursit të ngarkuara në rezultatin financiar	-	(111.753)
Ndryshime të parealizuara pozitive të kursit dhe çmimesh nga ari	33.161.518	22.604.927
Ndryshime të parealizuara negative të kursit dhe çmimesh nga ari	(24.528.910)	(20.325.758)
Gjithsej	8.570.285	2.087.747

8. Të hyrat neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit dhe instrumenteve financiare të derivateve

	2024	2023
Fitimet e realizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	685.136	887.265
Humbjet e realizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	-	(19.154)
Ndryshimet pozitive të çmimeve të përealizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, neto	1.406.855	1.605.706
Ndryshimet negative të çmimeve të përealizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, neto	(22.181)	(1.731)
Të hyra nga interesi të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	483.899	594.681
Gjithsej të hyrat neto të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	2.553.709	3.066.767
Ndryshime pozitive të përealizuara të çmimeve nga transaksionet e mbuluara të shkëmbimit të transaksioneve	59.828	-
Fitimet e realizuara nga transaksionet e së ardhmes	47.665	-
Humbjet e realizuara nga transaksionet e së ardhmës	(38.154)	-
Gjithsej të hyrat neto nga instrumentet financiare derivative	69.339	-
Gjithsej të hyrat neto nga letrat me vlerë të matura sipas bilancit të suksesit dhe instrumenteve financiare të derivateve	2.623.048	3.066.767

9. Të hyra neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithpërfshirëse

	2024	2023
Fitimet e realizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës	129.215	58.238
Hupjet e realizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës	(1.374)	-
Ndryshimet negative të çmimeve të përealizuara nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, neto	-	(11.365)
Gjithsej të hyra neto nga letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës	127.841	46.873

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***10. Kursi neto i realizuar dhe ndryshimet e çmimeve**

	2024	2023
Diferencat pozitive të kursit të realizuara nga arbitrazhi me bankat e huaja, neto	63.033	36.471
Diferencat e realizuara pozitive të kursit nga remitancat	61.949	52.347
Diferencat pozitive të kursit të realizuara nga transaksionet me tregun valutor me shtet, neto	43.390	81.365
Diferencat pozitive të kursit të realizuara nga ndërhyrjet me bankat vendase, neto	8.462	27.973
Diferencat pozitive/negative të realizuara të kursit mbi baza tjera, neto	3.464	(14)
Gjithsej	180.298	198.142

Ndryshimet e realizuara pozitive të ndryshimit të kursit, neto, rrjedhin nga dallimi mes kursit mesatar të shitjes dhe kursit gjatë shitjes së valutës së huaj të organeve shtetërore për realizimin e pagesave valutore ndaj vendeve të huaja si dhe nga shitblerja e valutave me bankat e huaja dhe nga ndërhyrjet në tregun e valutave me bankat vendase.

11. Të hyra nga dividendët

	2024	2023
Të hyrat nga dividendët nga investimet në BIS	11.993	9.223
Gjithsej	11.993	9.223

Në vitin 2024, Banka Popullore realizoi të hyra nga dividendët e investimeve në BIS. Dividenda u pagua në korrik të vitit 2024, në bazë të vendimit të miratuar në takimin 94-të vjetorë të BIS-it që të paguhet dividenda e rregullt për vitin 2024/2023. Në vitin 2023, dividenda u pagua në qershor të vitit 2023, në bazë të vendimit të miratuar në takimin 93-të vjetorë të BIS-it që të paguhet dividenda e rregullt për vitin 2023/2022.

12. Të hyra të tjera

	2024	2023
Të hyra nga huazimi automatik i letrave me vlerë	19.149	14.762
Të hyra nga mirëmbajtja e Kompleksit të Bankave	16.716	15.195
Të hyra nga tarifat e anëtarësimit të rimbursuara	3.775	-
Të hyra nga mjetet e rimbursuara për udhëtime zyrtare jashtë vendit	3.466	2.647
Të hyra nga shkarkimi, ruajtje dhe lëshimi pullave të kontrollit-banderolë	2.741	2.639
Të hyra në bazë të shlyerjes së vonuar nga bankat e huaja	2.247	3.360
Të hyra nga dënimi kontraktual për vonesë ose mospërbushje të kontratës	1.716	18
Të hyra në baza tjera	3.932	5.764
Gjithsej	53.742	44.385

13. Të dala për punëtorët

	2024	2023
Paga dhe tatimi personal	458.363	394.659
Kontribute për sigurim pensional	119.688	103.052
Kontribute të detyrueshme	58.570	50.430
Shpenzime të tjera për punonjësit	40.553	22.894
Gjithsej	677.174	571.035

Më 31 dhjetor 2024, numri total i të punësuarve në Bankën Popullore shënon 459 (2023: 457).

Të dala për punonjësit referohen në përfitimet afatshkurtra të punonjësve. Të dala të pagave për udhëheqësinë kryesore të Bankës Popullore për vitin 2024 shënojnë 26.239 mijë MKD (2023: 21.499 mijë MKD) dhe janë të përfshirë në të dalat e punonjësve.

14. Të dala tjera

	2024	2023
Të dala për shërbime të pranura	98.993	101.472
Të dala të lidhura me përpunim të monedhave dhe kartmonedhave	66.615	89.648
Të dala të përgjithshme dhe materialet	38.322	35.871
Të dala të tjera administrative	26.687	19.891
Të dala në baza tjera	1.129	1.297
Gjithsej	231.746	248.179

Të dalat e lidhura me përpunimin e monedhave dhe kartmonedhave i referohen kryesisht monedhave dhe kartmonedhave të blera. Shtypja e kartmonedhave dhe i farkëtimi i monedhave bëhet nga prodhues të vendit dhe të huaj. Banka Popullore zbaton politikë të kufizimit të shpenzimeve lidhur me përpunimin e kartmonedhave dhe monedhave varësisht nga qëndrueshmëria e tyre, dhe atë në periudhë prej dy deri në katër vjet.

15. Shpërndarja e rezervës së veçantë dhe zhvlerësimi, neto

	Shënimi	2024	2023
Shpërndarja e zhvlerësimit për humbje të pritshme kreditore të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës, neto	44	6.756	1.132
(Lirimi) zhvlerësimi për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë të huaja sipas vlerës së amortizuar blerëse, neto	18	(1.531)	(406)
(I liruar)/Shpërndarja e zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të depozitave të afatizuara në valutë të huaj, neto	17	(103)	201
(I liruar) zhvlerësimi i kredive dhe plasmaneve	26	-	(800)
Shpërndarja e zhvlerësimit të kërkesave nga tarifa dhe provizione, neto	30	1.328	1.676
(I liruar)/Shpërndarja e zhvlerësimit të kërkesave të punës, neto	30	(457)	659
Shpërndarja e zhvlerësimit të kërkesave të interesave, neto	30	-	6.985
(I liruar)/Shpërndarja e rezervës speciale për detyrimet e mundshme nga proceset gjyqësore, neto	42	(308)	29
Gjithsej shpërndarja e rezervës speciale dhe përmirësimi i vlerës, neto		5.685	9.476

Zhvlerësimi i alokuar i mjeteve financiare në vitin 2024 lidhet më së shumti me zhvlerësimin e humbjeve të pritshme të kredisë në letrat me vlerë të huaja matur me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera të përgjithshme, në vlerë të përgjithshme prej 6.756 mijë denarë, që është kryesisht rezultat i rritjes së vëllimit të portofolit, dhe pjesërisht vjen si pasojë e pritjeve për përkeqësim të zhvillimeve makroekonomike në eurozonë.

Zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë nga letrat me vlerë të matura me shpenzime të amortizuar regjistroi çlirim neto në vlerë prej 1.531 MKD, e cila është kryesisht për shkak të reduktimit të maturimit të mbetur të flukseve monetare të ardhshme nga mjetet e investuara tashmë në këtë lloj letrash me vlerë dhe maturimit të letrave me vlerë në vitin 2024.

16. Paratë e huaja efektive

	2024	2023
Euro	395.629	531.678
Dollar amerikan	271.353	270.410
Funta britanike	4.753	5.860
Dollarë australian	4.615	5.036
Franga zvicerane	2.715	2.104
Dollar kanadez	2.133	2.271
Valuta tjera	3.932	4.248
Gjithsej	685.130	821.607

Paratë e huaja efektive përfshijnë para të gatshme në valutë të huaj. Paratë e huaja efektive janë të përfshira në ekuivalentet monetare për nevojat e Raportit të rrjedhave monetare (shënimi 45).

17. Depozita në valutë të huaj

	2024	2023
Depozita valutore pa afat	17.199.550	76.758.735
Depozita valutore me afat në banka të huaja	35.477.450	31.101.436
Zhvlerësim të vlerës për humbjen e pritur kreditore	(124)	(252)
Përfshirë në paratë dhe ekuivalentet monetare (shënimi 45)	52.676.876	107.859.919
Depozita valutore me afat në banka të huaja mbi 90 ditë	5.497.237	-
Zhvlerësimi për humbjen e pritur kreditore	(25)	-
Gjithsej	58.174.088	107.859.919
Aktuale	58.174.088	107.859.919

Depozitat pa afat më 31 dhjetor 2024 përfshijnë interesin e përlogaritur në vlerë prej 14,707 mijë MKD (2023: interesi neto i përlogaritur në shumën prej 179.220 mijë MKD). Depozitat e afatizuara në valutë të huaj më 31 dhjetor 2024 e përfshijnë interesin e llogaritur me vlerë prej 172.872 mijë MKD (2023: 21.863 mijë MKD).

Më 31 dhjetor 2024, gjendja e zhvlerësimit të vlerës për humbjen e pritur kreditore të depozitave të afatizuara arrin 149 mijë MKD (2023: 252 mijë MKD). Zhvillimi i zhvlerësimit të vlerës për humbjen e pritur kreditore të depozitave të afatizuara është shfaqur në tabelën më poshtë:

17. Depozita në valutë të huaj (vazhdon)

	Shënim	2024	2023
Gjendja më 1 janar		252	51
Rritja e zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të depozitave të afatizuara në valutë të huaj	15	149	252
(Lirimi) i zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të depozitave të afatizuara në valutë të huaj	15	(252)	(51)
Gjendja më 31 dhjetor		149	252

Normat mesatare të interesit të depozitave varësisht nga valuta e depozitit dhe për investimet përkatëse në depozita, gjatë vitit 2024 dhe 2023, në nivel vjetor arritën:

Norma e interesit	2024	2023
- depozita njëditore në USD-dollar	5,12%	4,99%
- depozita njëditore në euro	3,76%	3,29%
- depozita të afatizuara në euro	3,63%	3,57%
- depozita të afatizuara në kruna norvegjeze	4,42%	4,22%

Depozita në valutë të huaj sipas llojit të subjektit

	2024	2023
Bankat	32.568.016	76.722.165
Banka të huaja afariste	25.595.359	29.592.570
Institucione financiare ndërkombëtare	10.713	1.545.184
Gjithsej	58.174.088	107.859.919

Depozita në valutë të huaj sipas lokacionit gjeografik

	2024	2023
Europa	50.672.244	98.789.539
Azi	6.195.560	7.214.019
Amerika Veriore	1.306.284	1.856.361
Gjithsej	58.174.088	107.859.919

18. Letrat me vlerë të huaj

Banka Popullore ka investime në letrat me vlerë të borxhit të huaja dhe letra pronësie të huaja me vlerë. Investimet në Bankën Popullore në letrat me vlerë të borxhit me cilësi të lartë klasifikohen si letra me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, letra me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse dhe letrave me vlerë të borxhit sipas vlerës së amortizuar blerëse, ndërsa investimet në letra me vlerë pronësie klasifikohen si letra me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse.

	2024	2023
Obligacione	59.942.930	70.715.421
Regjistrat e diskontuara	9.580.979	4.268.088
Certifikat për depozit	8.199.991	3.232.607
Regjistrat komerciale	7.365.522	3.010.235
Letrat me vlerë të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	85.089.422	81.226.351
Obligacione	74.285.464	14.888.694
Regjistrat komerciale	7.986.973	5.373.812
Certifikat për depozit	3.686.619	1.226.925
Regjistrat e diskontuara	1.520.947	606.550
Letrat me vlerë të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse	87.480.003	22.095.981
Obligacione	43.827.307	41.910.363
Zhvlerësim të vlerës për humbjen e pritur kreditore	(7.926)	(9.457)
Letrat me vlerë të borxhit të matura sipas vlerës së amortizuar blerëse, neto	43.819.381	41.900.906
Letrat e pronësisë me vlerë – BIS	41.139	40.060
Letrat e pronësisë me vlerë – SWIFT ²²	2.967	2.863
Letrat e pronësisë me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse	44.106	42.923
Gjithsej	216.432.912	145.266.161
Aktuale	185.435.559	105.422.382
Joaktuale	30.997.353	39.843.779

Portofoli i letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit e përbëjnë letra me vlerë të borxhit me cilësi të lartë në të cilat përfshihen obligacionet, regjistrat e diskontuara, certifikatat e depozitave dhe regjistrat komerciale. Investimet në letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit janë në pajtim me vlerën objektive dhe sjellin të hyra fikse me normën e interesit mes 0% dhe 4,85% në vit (2023: mes 0% dhe 4,85% në vit).

²² Shoqëria për Telekomunikacionet Ndërbankare Botërore (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunications) – SWIFT.

18. Letra të huaja me vlerë(vazhdon)

Letrat e huaja me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit përfshijnë interesin e llogaritur në vlerë prej 325.959 mijë MKD (2023: 197.283 mijë MKD).

Banka Popullore ka investime në letra me vlerë të borxhit me të cilat filloi ti menaxhojë në pajtim me modelin afarist qëllimi i së cilës ishte arkëtimi i të hyrave monetare të kontraktuara në datën e akorduar të maturimit ose shitje para maturimit shkaku i nevojave për likuiditet ose për arritjen e fitimit nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve. Ndryshimet në vlerën objektive të këtyre investimeve njihen në Raportin e fitimit gjithpërfshirës të mbetur

Investimet në letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të fitimit gjithpërfshirës të mbetur janë në pajtim me vlerën objektive dhe sjellin të hyra fikse me normën e interesit mes 0% dhe 4,85% në vit (2023: mes 0% dhe 2,875% në vit). Letrat me vlerë të huaj të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit gjithpërfshirës të mbetur përfshijnë edhe interesin e llogaritur në vlerë prej 626.038 mijë MKD (2023: 69.208 mijë MKD).

Për investimet në këto letra me vlerë llogaritet zhvlerësimi i vlerës për humbjen e pritur kreditore dhe ajo njihet në Raportin për fitimin gjithpërfshirës të mbetur. Më 31 dhjetor 2024, gjendja e zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithpërfshirëse arrin 6.756 mijë MKD (2023: 1.132 mijë MKD) (shënimet 15 dhe 44).

Letrat me vlerë sipas vlerës së amortizuar blerëse sjellin të hyra fikse me normë të interesit prej 0% dhe 4,85% në vit (2023: mes 0% dhe 4,85% në vit). Letrat me vlerë të huaja të matura sipas vlerës së amortizuar blerëse përfshijnë interesin e llogaritur në vlerë prej 303.682 mijë MKD (2023: 250.024 mijë MKD).

Më 31 dhjetor 2024, gjendja e zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë sipas vlerës së amortizuar blerëse arrin 7.926 mijë MKD (2023: 9.457 mijë MKD). Zhvillimi i zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë sipas vlerës së amortizuar blerëse është shfaqur në tabelën më poshtë:

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***18. Letrat me vlerë të huaj (vazhdon)**

	Shënim	2024	2023
Gjendja më 1 janar		9.457	9.862
Rritja e zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë sipas vlerës së amortizuar blerëse	15	1.315	569
(Përrjashtimi) i zhvlerësimit për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë sipas vlerës së amortizuar blerëse	15	(2.846)	(975)
Efekt i diferencave të llogaritura të kursit		-	1
Gjendja më 31 dhjetor		7.926	9.457

Letrat e pronësisë me vlerë nga BIS dhe SWIFT, nuk kuotojnë në treg dhe klasifikohen si letra me vlerë të matura me vlerën objektive nëpërmjet të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse.

Më 31 dhjetor të vitit 2024 dhe 2023, Banka Popullore ka në dispozicion 430 aksione të thjeshta nga BIS-i (vlerë nominale prej 5.000 SPB për aksion - të pagueshme 25% nga vlera e tyre nominale). Vlera objektive e aksioneve të BIS-it nuk mund të përcaktohet realisht, për arsye që paraqiten sipas vlerës së tyre blerëse. Në këtë mënyrë llogaritet se vlera e tyre blerëse e rrefekton vlerën e tyre objektive.

Më 31 dhjetor të vitit 2024 dhe 2023, Banka Popullore ka në dispozicion 6 aksione të thjeshta nga SWIFT me vlerë nominale prej 125 EUR për aksion të blera me çmim të blerjes prej 5.915 EUR për aksion. Vlera objektive e aksioneve të SWIFT-it më 31 dhjetor 2024 shënon 8.040 EUR për aksion (2023: 7.760 EUR për aksion), në pajtim me të dhënat e publikuara nga kompania.

19. Instrumentet derivative

	2024	2023
Swap-transaksionet e mbuluara valutore	59.828	-
Gjithsej	59.828	-

Në dhjetor 2024, Banka Popullore realizoi transaksione *swap* të mbuluara valutore me vlerë nominale prej 2.452.187 mijë MKD (2023: nuk ka). Vlera objektive e transaksioneve *swap* të mbuluara valutore më 31 dhjetor 2024 është 59.828 mijë MKD dhe është rezultat i ndryshimit pozitiv në vlerën objektive.

Banka Popullore gjatë vitit 2024, realizoi transaksione me kontrata të së ardhmës së detyrimeve në vlerë totale nominale prej 8.478.821 mijë MKD (2023: nuk ka). Më 31 dhjetor 2024, Banka Popullore nuk ka pozicione të hapura me kontrata të së ardhmës.

Fitimet dhe humbjet nga ndryshimet në vlerën objektive të instrumenteve derivative njihen në bilancin e suksesit (shënimi 8).

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)

20. Ari

	2024	2023
Depozita ari pa afat	15.559.402	19.636.543
Depozita ari me afat	18.450.418	5.754.053
Ari në thesarin e Bankës Popullore	62.029	46.312
Gjithsej	34.071.849	25.436.908
Aktuale	34.071.849	25.436.908

Totali i depozitave të arit dhe ari në thesarin e Bankës Popullore, deri më 31 dhjetor 2024, shënojnë 221.617,0413 ons (2023: 221.617,0397 ons) me vlerë objektive prej 2.610,85-dollar ose 154 mijë mkd për ons (2023: 2.062,40 USD-dollar ose 115 mijë MKD për ons).

Normat e interesit të depozitave me afat të arit në vitin 2024 lëviznin në interval prej 0,1% deri 0,55% në vjet për depozitat e arit të bazuara në çmimin e arit në USD-dollar (2023: prej 0,17% deri 0,52% në nivel vjetor). Më 31 dhjetor 2024, depozitat e afatizuara të arit e përfshijnë interesin e llogaritur me vlerë prej 2.955 mijë MKD (2023: 622 mijë MKD).

21. Të drejtat speciale të tërheqjes

Banka Popullore ka llogari aktuale te FMN-ja të denominuar në DST, e cila përdoret për përpunimin dhe shlyerjen e të gjitha transaksioneve me FMN-në. Më 31 dhjetor 2024, të drejtat speciale të tërheqjes shënojnë 71.116 mijë MKD (2023: 13.249 mijë MKD).

Llogaria aktuale te FMN-ja mbart interes në shumën e të ashtuquajturës normë bazë të FMN-së. Gjatë vitit 2024, norma bazë varionte ndërmjet 3,159% dhe 4,136%, në vit (2023: mes 2,916% dhe 4,198% në nivel vjetor). Të drejtat speciale të tërheqjes janë të përfshira në ekuivalentet monetare për nevojat e Raportit të flukseve monetare (shënimi 45).

22. Kërkesat mbi bazën e repo-transaksioneve valutore

	2024	2023
Transaksionet repo të anasjellta në valutë të huaj me kolateral të pranuar në letra me vlerë	5.359.030	-
Gjithsej	5.359.030	-
Aktuale	5.359.030	-

Në vitin 2024 dhe 2023, Banka Popullore ka lidhur transaksione repo të ndërsjella me banka të huaja me kolateral të pranuar në letra me vlerë.

22. Kërkesat e bazuara në transaksionet e repove në valutë të huaj (vazhdon)

Më 31 dhjetor 2024, kërkesat në bazë të transaksioneve repo të anasjellta e përfshijnë interesin e llogaritur në vlerë prej 4.432 mijë MKD, ndërsa vlera e tregut e kolateralit të pranuar në letra me vlerë (bono qeveritare me rejting kreditor AA-prej BBB) shënon 5.346.667 mijë MKD.

Më 31 dhjetor 2023, Banka Popullore nuk ka kërkesa në bazë të transaksioneve repo kthyesë me kolateral të pranuar në letra me vlerë.

23. Kërkesa nga shteti për marrëdhëniet me FMN-në

	Shënim	2024	2023
Kërkesat nga shteti në bazë të alokimit neto kumulativ, në emër dhe në llogari të FMN-së			
Kërkesa në bazë të përdorimit të alokimit të përgjithshëm nga viti 2021	40a	10.292.173	10.022.047
Kërkesa e lidhur me alokimin neto kumulativ të përgjithshëm dhe të posaçëm nga viti 2009	40a	4.380.902	4.265.922
Kërkesa lidhur me obligacionin në bazë të alokimit të trasheguar në DST	40a	641.289	624.458
Gjithsej		15.314.364	14.912.427
Kërkesat nga shteti në bazë të përdorimit të linjave kreditore nga FMN-ja, në emër dhe në llogari të FMN-së			
Kërkesa në bazë të përdorimit të mjeteve nga linja kreditore PLL ²³	40b	15.673.045	6.327.952
Kërkesa në bazë të përdorimit të mjeteve nga linja kreditore RFI ²⁴	40b	2.702.183	7.909.940
Gjithsej		18.375.228	14.237.892
Gjithsej		33.689.592	29.150.319
Aktuale		18.118.681	20.262.327
Joaktuale		15.570.911	8.887.992

E kundërta e këtyre pozitave aktive të bilancit është detyrimi ndaj FMN-së në bazë të alokimit të DST-së dhe kredive të përdorura nga FMN-ka, në emër dhe në llogari të shtetit.

²³ Linja e maturisë dhe likuiditetit (Precautionary and Liquidity Line) – PLL.

²⁴ Instrument për financim të shpejtë (Rapid Financial Instrument) – RFI.

24. Anëtarësimi në FMN

Në pajtim me Statutin e FMN-së, i cili është ratifikuar nga Kuvendi, si dhe në pajtim me Ligjin e Trashëgimisë Juridike të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Banka Popullore vepron si agjent fiskal i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njëkohësisht vepron si depozitues i FMN-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë cilësi, Banka Popullore mban evidencë për kuotën e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në FMN, si dhe llogaritë nr. 1 dhe 2.

Më 31 dhjetor 2024, kuota e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në FMN shënon 10.579.694 mijë MKD, llogaria nr. 1 shënon 26.516 mijë MKD dhe llogaria nr. 2 shënon 153 mijë MKD (2023: 10.502.049 denarë, 26.321 denarë dhe 152 denarë, përkatësisht, për tre pozitat). Ndryshimet janë rezultat i vlerësimit të kryer të këtyre pozitave me kurs të DST-së nga 30 prill 2024 sipas vitit financiar të FMN-së (shënimi 40c).

25. Kredi që u jepen bankave

Më 31 dhjetor, 2024 dhe 2023, Banka Popullore nuk ka kërkesa nga bankat vendase në bazë të kredive të dhëna, as kërkesa për kredi të miratuara për transaksionet e repove në ankand të realizuara me bankat vendase.

26. Kërkesa të tjera

	2024	2023
Kërkesa nga bankat në falimentim	730.039	730.039
Kërkesa nga bankat në bazë të depozitave të maturuara ankandesh	4.468	4.468
Gjithsej	734.507	734.507
Zhvlerësimi i kërkesave	(734.507)	(734.507)
Gjithsej	-	-

Në janar 2004, Banka Popullore pagoi 1.018.258 mijë MKD për bankat e huaja në bazë të garancive për kredi të një banke maqedonase nga bankat e huaja, të dhëna në bazë të Vendimit për kriteret dhe kushtet e përdorimit të një pjese nga rezervat valutore në bazë të garancive për kredi të një banke maqedonase nga bankat e huaja, e cila ndaloi së vlejuri nga marsi 2003. Banka Popullore krijoi kërkesa nga bankat vendase. Procedurat e falimentimit u nisën kundër bankës në mars 2004. Banka Popullore evidentoi kërkesa në bazë të garancive të ofruara nga banka në falimentim në vlerë prej 1.034.569 mijë MKD. Banka Popullore kreu zhvlerësim total të kërkesave nga banka në falimentim.

26. Kërkesa të tjera (vazhdon)

Në periudhën prej vitit 2010 deri 2019, Banka Popullore arkëtoi një pjesë të kërkesave nga bankat në falimentim, në vlerë prej 304.530 mijë MKD nga të cilat: 231.234 mijë MKD janë të paguara në bazë të atkvendimit për shpërndarje të avansit nga pasuria falimentuese e bankave vendase në falimentim dhe nga pasuria falimentuese e një debitori të bankave vendase në falimentim dhe 73.296 mijë MKD janë të arkëtuara në bazë të mjeteve të marra për kërkesat e pashlyera. Në vitin 2024 dhe 2023 nuk kishte pagesa të këtyre kërkesave.

Kërkesa e maturuar e papaguar në bazë të depozitave të maturuara të ankandit i referohet depozitave të ankandëve të një banke tjetër vendase të cilat nuk janë kthyer në kohë. Në vitin 1999 u nis procedurë falimentimi kundër kësaj banke, e cila ende është në vazhdim. Banka Popullore tërësisht i ka rezervuar kërkesat nga banka në falimentim në vlerë prej 9.268 mijë MKD. Në periudhën prej vitit 2013 deri 2023, Banka Popullore pagoi një pjesë të kërkesave në disa raste, me vlerë totale prej 4.800 mijë MKD. Në vitin 2023 është paguar një pjesë e kërkesës në vlerë prej 800 mijë MKD (shënimi 15). Në vitin 2024 nuk kishte pagesa të këtyre kërkesave.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***27. Patundshmëri dhe pajisje**

	Tokë dhe ndërtesa	Mobilje, pajisje dhe automjete	Vepra artistike	Fondi biblote -kës	Investimet në vijim	Mjetet totale për qëllime biznesi	Mjetet për qëllime rekreative	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2023								
Vlera blerëse	815.529	584.055	64.361	5.225	1.064.662	2.533.832	34.155	2.567.987
Zhvlerësimi i akumuluar	(525.187)	(518.255)	-	-	-	(1.043.442)	(23.264)	(1.066.706)
Gjendja më 1 janar 2023, vlera aktuale	290.342	65.800	64.361	5.225	1.064.662	1.490.390	10.891	1.501.281
Rritja e mjeteve gjatë vitit								
- vlera blerëse	5.136	85.672	-	407	1.781	92.996	-	92.996
Reduktimi i mjeteve gjatë vitit								
- vlera blerëse	(4.554)	(99.286)	-	-	-	(103.840)	(71)	(103.911)
- zhvlerësimi i akumuluar	4.554	99.285	-	-	-	103.839	71	103.910
Transferime								
- vlera blerëse	-	9.132	-	-	(9.416)	(284)	284	-
- zhvlerësimi i akumuluar	-	284	-	-	-	284	(284)	-
Zhvlerësimi për vitin	(25.010)	(31.414)	-	-	-	(56.424)	(641)	(57.065)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	270.468	129.473	64.361	5.632	1.057.027	1.526.961	10.250	1.537.211
Gjendja më 31 dhjetor 2023								
Vlera blerëse	816.111	579.573	64.361	5.632	1.057.027	2.522.704	34.368	2.557.072
Zhvlerësimi i akumuluar	(545.643)	(450.100)	-	-	-	(995.743)	(24.118)	(1.019.861)
Vlera aktuale	270.468	129.473	64.361	5.632	1.057.027	1.526.961	10.250	1.537.211

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***27. Patundshmëri dhe pajisje (vazhdon)**

	Tokë dhe ndërtesa	Mobilje, pajisje dhe automjete	Vepra artistike	Fondi i bibliote-kës	Investimet në proces	Mjetet totale për qëllime biznesi	Mjetet për qëllime rekreative	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2024								
Vlera blerëse	816.111	579.573	64.361	5.632	1.057.027	2.522.704	34.368	2.557.072
Zhvlerësimi i akumuluar	(545.643)	(450.100)	-	-	-	(995.743)	(24.118)	(1.019.861)
Gjendja më 1 janar 2024, vlera aktuale	270.468	129.473	64.361	5.632	1.057.027	1.526.961	10.250	1.537.211
Rritja e mjeteve gjatë vitit								
- vlera blerëse	2.927	11.536	-	24	973	15.460	-	15.460
- zhvlerësimi i akumuluar	-	(71)	-	-	-	(71)	-	(71)
Reduktimi i mjeteve								
- vlera blerëse	-	(4.335)	-	-	-	(4.335)	-	(4.335)
- zhvlerësimi i akumuluar	-	4.307	-	-	-	4.307	-	4.307
Transferime								
- vlera blerëse	-	1.446	-	-	(1.162)	284	(284)	-
- zhvlerësimi i akumuluar	-	(284)	-	-	-	(284)	284	-
Zhvlerësimi për vitin	(25.564)	(33.747)	-	-	-	(59.311)	(643)	(59.954)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	247.831	108.325	64.361	5.656	1.056.838	1.483.011	9.607	1.492.618
Gjendja më 31 dhjetor 2024								
Vlera blerëse	819.038	588.220	64.361	5.656	1.056.838	2.534.113	34.084	2.568.197
Zhvlerësimi i akumuluar	(571.207)	(479.895)	-	-	-	(1.051.102)	(24.477)	(1.075.579)
Vlera aktuale	247.831	108.325	64.361	5.656	1.056.838	1.483.011	9.607	1.492.618

27. Patundshmëri dhe pajisje (vazhdon)

Mjetet bazë për qëllimet rekreative përfshijnë ndërtesa dhe mjete të tjera elementare në kuadër të atyre ndërtesave.

Si pjesë e reformave të sistemit të pagesave, në vitin 2001 Banka Popullore e mori funksionin për furnizim me para të gatshme nga ish Enti i Qarkullimit të Pagesave (EQP), si dhe pjesë të ndërtesave, pajisjeve dhe mobiljeve të EQP-së të lidhura me atë funksion në dhjetë qytete në shtet. Këto mjete bazë i janë dorëzuar Bankës Popullore, por pronësia ende nuk është bartur për shkak të mosplotësimit të bilancit të pjesshëm të EQP-së dhe rrjedhimisht, mjetet nuk janë evidentuar në librat e punës së Bankës Popullore.

Në vitin 2013, me vendim të Qeverisë, Bankës Popullore iu dha e drejta për shfrytëzim të përhershëm të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ndërtim të objektit të ri afarist. Toka nuk është evidentuar në librat e Bankës Popullore.

Më 31 dhjetor 2024, gjendja e investimeve gjatë ndërtimit të objektit të ri afarist arrin 1.056.838 mijë MKD (2023: 1.055.865 mijë MKD). Në vitin 2024, Banka Popullore kishte investime në flukset në vlerë prej 973 mijë MKD (2023: 619 mijë MKD), të lidhura me ndërtimin e objektit të ri afarist.

Në prill 2023 është hapur procedurë falimentimi mbi ish kontraktuesin e objektit të ri afarist të Bankës Popullore (Banka Popullore ndërpreu kontratën për kryerjen e punëve ndërtimore në korrik 2022, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve nga kontraktori sipas marrëveshjes). Pas ndërprerjes së kontratës me kontraktorin, Banka Popullore ndërmarr aktivitetet lidhur me vazhdimin e ndërtimit të objektit të ri afarist.

Në vitin 2024 dhe 2023, Banka Popullore nuk ka barra në patundshmëri dhe pajisje.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***28. Mjetet jomateriale**

	2024	2023
Gjendja më 1 janar		
Vlera e blerjes	336.664	296.594
Investimet në vijim	-	605
Amortizimi i mbledhur	(289.943)	(268.925)
Vlera aktuale	46.721	28.274
 Rritja e mjeteve gjatë vitit		
- vlera e blerjes	9.779	40.070
Amortizimi për vitin	(23.154)	(21.018)
Investimet në vijim	242	(605)
Gjendja më 31 dhjetor	33.588	46.721
 Gjendja më 31 dhjetor		
Vlera blerëse	346.443	336.664
Investimet në vijim	242	-
Amortizimi i mbledhur	(313.097)	(289.943)
Vlera aktuale	33.588	46.721

29. Monedha nga metale të çmuara

Më 31 dhjetor 2024 gjendja e monedhave nga metalet e çmuara arrin 7.594 mijë denarë (2023: 6.082 mijë MKD).

Monedhat e metaleve të çmuara përfshijnë monedhat përkujtimore, monedhat për qëllime të koleksionit dhe kompletet me monedha.

Monedhat përkujtimore janë prej ari dhe argjendi të cilat në bazë të vendimit të Qeverisë prodhohen për të përkujtuar përvjetorë të rëndësishëm të shtetit. Më 31 dhjetor 2024, Banka Popullore kishte në disponim 173 monedha ari dhe 19 monedha argjendi (2023: 173 monedha ari dhe 24 monedha argjendi).

Në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore, nga qershor vitit 2014, Banka Popullore filloi me aktivitetin e shitjes së monedhave për qëllime koleksionimi, të cilat njëkohësisht janë edhe mjet pagesor. Në vitin 2016 Banka Popullore filloi me shitjen e monedhave për qëllime koleksionimi dhe me punë komisionimi. Më 31 dhjetor 2024, Banka Popullore kishte në disponim 125 monedha për qëllime koleksionimi (2023: 176 copë).

Më 31 dhjetor 2024, Banka Popullore kishte në disponim 2.676 komplete të monedhave (2023: 2.752 copë).

30. Kërkesat nga operacionet

Kërkesat nga operacionet përbëhen nga valutat e huaja në bazë të interesave të paguara, provizioneve dhe shpenzimeve të tjera për llogarinë e shtetit në bazë të alokimit të mbledhur neto (AMN) nga FNM-ja, kërkesat në bazë të tarifave dhe provizioneve për shërbime të realizuara nga Banka Popullore, kërkesa për mirëmbajtjen e Kompleksit të Bankave dhe kërkesave tjera:

	2024	2023
Kërkesat në valuta të huaja në bazë të interesave të paguar, provizioneve dhe shpenzimeve të tjera për llogari të shtetit (AMN)	85.137	103.611
Tarifa dhe provizione	64.312	46.851
Kërkesa për mirëmbajtjen e Kompleksit të Bankave	3.335	2.448
Kërkesa tjera	575.159	574.492
Zhvlerësimi i kërkesave tjera	(575.159)	(574.492)
Gjithsej	152.784	152.910

Zhvillimi i zhvlerësimit të kërkesave tjera është shfaqur në vazhdim:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	574.492	564.844
Rritja e zhvlerësimit për kërkesat nga tarifatat dhe provizionet (shënimi 15)	1.328	1.676
Shlyerja/Rritja e kërkesave të dyshimta dhe kontestuese	(205)	329
Ulja/Rritja e zhvlerësimit të vlerës për kërkesat nga operacionet (shënimi 15)	(457)	659
Rritja e zhvlerësimit të vlerës për kërkesat nga interesi (shënimi 15)	-	6.985
Efkti i diferencave të llogaritura të kursit	1	(1)
Gjendja më 31 dhjetor	575.159	574.492

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***31. Mjetet tjera**

	2024	2023
Shpenziemt e llogaritura për kartëmonedhat dhe monedhat e blera	140.093	82.898
Furnizime për zyra dhe të tjera	19.586	19.679
Shpenzime të tjera të llogaritura	19.229	5.959
Avanset e dhëna	15.407	5.813
Kërkesa tjera në valutë të huaj	2.786	850
Mjete në baza tjera	220	250
Mjete të marra në bazë të kërkesave të pashlyera	55.848	55.848
Mjete të marra në bazë të kërkesave të pashlyera	(55.848)	(55.848)
Gjithsej	197.321	115.449
Aktuale	177.735	95.770
Joaktuale	19.586	19.679

Shpenzimet e llogaritura për kartëmonedhat dhe monedhat e blera i referohen detyrimeve kontraktuale të paguara për kartëmonedhat dhe monedhat e blera.

32. Paratë e gatshme në qarkullim

Ndryshimet në paratë e gatshme në qarkullim gjatë vitit janë të shfaqura në tabelën mëposhtë:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	57.208.828	53.852.538
Rritja neto e parave në qarkullim gjatë vitit	9.172.669	3.356.290
Gjendja më 31 dhjetor	66.381.497	57.208.828

Struktura e vlerës nominale dhe sasia e parave në qarkullim janë të shfaqura si në vijim:

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***32. Para të gatshme në qarkullim (vazhdon)**

MKD	Vlera nominale	2024		2023	
		Copë	Vlerë në mijëra MKD	Copë	Vlerë në mijëra MKD
Para të gatshme në qarkullim (mjet ligjor për pagesë)					
Kartëmonedha	100	20.173.508	2.017.351	18.842.319	1.884.232
	200	893.311	178.662	908.253	181.650
	500	10.811.940	5.405.970	9.691.259	4.845.630
	1000	21.919.867	21.919.867	21.506.132	21.506.132
	2000	17.240.001	34.480.002	13.269.452	26.538.904
Totali i kartëmonedhave			64.001.852	54.956.548	
Kartëmonedha me përbërje polimeri	10	33.241.236	332.412	33.637.225	336.372
	50	7.303.766	365.188	7.074.414	353.721
Totali i kartëmonedhave me përbërje polimeri			697.600	690.093	
Monedha	1	130.594.734	130.595	127.208.105	127.208
	2	100.419.171	200.838	94.110.466	188.221
	5	54.099.174	270.496	51.582.505	257.912
	10	46.922.954	469.230	40.867.108	408.671
	50	6.174.671	308.734	5.554.893	277.745
Totali monedhave			1.379.893	1.259.757	
Para të gatshme në qarkullim (mjet ligjor për pagesë)			66.079.345	56.906.398	
Para të gatshme në qarkullim - monedha për qëllime koleksionimi					
Monedha	10	91.924	919	91.924	919
	100	101.435	10.143	101.384	10.139
	1000	557	557	557	557
	2000	45	90	45	90
Totali parave të gatshme në qarkullim - monedha për qëllime koleksionimi			11.709	11.705	
Para të gatshme në qarkullim që nuk janë mjet ligjor për pagesë					
Monedha	0,5	4.347.292	2.174	4.347.292	2.174
Kartëmonedha	10	16.915.688	169.157	16.918.792	169.188
Kartëmonedha	50	2.253.238	112.662	2.253.765	112.688
Kartëmonedha	5000	1.290	6.450	1.335	6.675
Totali i parave të gatshme në qarkullim që nuk janë mjet ligjor për pagim ²⁵			290.443	290.725	
Para të gatshme në qarkullim			66.381.497	57.208.828	

²⁵ Vendimi për tërheqjen e qarkullimit të monedhave me vlerë nominale prej 50 deni, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.54/12), Vendimi për tërheqjen e kartëmonedhave në qarkullim me vlerë nominale prej 5.000 denarëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.202/16), Vendimi për tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave me vlerë nominale prej 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.58/18).

33. Depozita të bankave dhe kursimoreve

	2024	2023
Depozita njëditore të disponueshme të bankave në MKD te Banka Popullore	9.181.007	24.090.000
Depozitat shtatëditore të bankave dhe kursimoreve në MKD te Banka Popullore	38.875.213	37.451.093
Depozitat e bankave dhe llogarive tjera të institucioneve financiare në MKD te Banka Popullore	37.256.778	19.503.128
Depozitat e bankave në valutë të huaj - MIPS EUR	11.416.755	12.162.790
Gjithsej	96.729.753	93.207.011
Aktuale	96.729.753	93.207.011

Bankat vendase, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret²⁶ kanë të drejtë të plasimit të mjeteve në depozitat e disponueshme te Banka Popullore. Afatet e maturimit të depozitave janë një ditë pune (njëditore) dhe shtatë ditë, pa mundësi të tërheqjes së parakohshme, të pjesërishme ose të tërësishme.

Gjatë vitit 2024, norma e interesit të depozitave të disponueshme njëditore varionte nga 4,20% deri 3,95% në nivel vjetor (2023: norma e interesit varionte prej 2,65% deri 4,20% në nivel vjetor), ndërsa, norma e interesit të depozitave të disponueshme deri në shtatë ditë varionte prej 4,25% deri 4% në nivel vjetor (2023: norma e interesit varionte prej 2,70% deri 4,25% në nivel vjetor). Depozitat e disponueshme njëditore të bankave e përfshijnë interesit e llogaritur në shumë prej 1.007 mijë MKD, ndërsa depozitat e disponueshme deri në shtatë ditë të bankave dhe kursimoreve e përfshijnë edhe interesin e llogaritur në shumë prej 30.213 mijë MKD (2023: 22.094 mijë MKD).

Detyrimet në bazë të depozitave ndaj bankave dhe llogarive tjera të institucioneve financiare në MKD i reflektojnë bilancet në llogaritë e tyre te Banka Popullore për shlyerjen e transaksioneve pagesore. Fondet e këtyre llogarive lidhen në plotësimin e rezervës së detyrueshme në denarë.

Banka Popullore nuk paguan interes të mjeteve në llogaritë në denarë të bankave te Banka Popullore nëpërmjet të cilave e plotësojnë detyrimin e rezervës së detyrueshme dhe pjesës tjetër të mjeteve të llogarive si dhe të llogarive të institucioneve financiare²⁷.

Për qëllimet e shlyerjes së bankave vendase, Banka Popullore ka llogari të hapura në euro në MIPS, për lidhjen e eurosistemit për pagesë TARGET 2.

²⁶ Vendim për depozitat e disponueshme, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 245/24.

²⁷ Llogaritë e Bankës së Zhvillimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për projekte të ndryshme.

33. Depozita të bankave dhe kursimoreve (vazhdon)

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, bankat vendase nuk kanë vendosur depozita në valutë të huaj në Bankën Popullore²⁸.

Në periudhën janar - prill 2023, banka plasoi depozita në valutë të huaj me afat deri 1 muaj dhe prej 1 deri 3 muaj. Norma e interesit të depozitave të afatizuara në valutë të huaj deri 1 muaj në vitin 2023 varionin në interval prej 1,20% deri 2,52%, ndërsa, normat e interesit të depozitave të afatizuara në valutë të huaj prej 1 deri 3 muaj varionin në interval prej 1,70% deri 2,80% në nivel vjetor.

34. Rezerva e detyrueshme e bankave në valuta të huaja dhe rezerva e detyrueshme e kursimoreve në denarë

	2024	2023
Rezerva e detyrueshme e bankave në valuta të huaja	35.899.043	35.217.918
Rezerva e detyrueshme e kursimoreve në MKD	10.420	24.079
Gjithsej	35.909.463	35.241.997
Aktuale	35.909.463	35.241.997

Në pajtim me rregullativën²⁹, bankat janë të obliguara të plotësojnë rezervën e detyrueshme në denarë dhe në valuta të huaja, ndërsa kursimoret kanë obligim për rezervën e detyrueshme në denarë. Detyrimi i rezervës së detyrueshme të kursimoreve plotësohet në nivel fiks.

Në vitin 2024, Banka Popullore ka llogaritur tarifë për shumën e ndarë në euro, me normë të barabartë se norma më e ulët prej 0% dhe normë të interesit të depozitit të disponueshëm njëditor të Bankës Qendrore Europiane e cila varionte në interval prej 4% deri 3% në nivel vjetor, ndërsa tarifa për tepicën e mjeteve mbi shumën e rezervës së detyrueshme të ndarë në euro është llogaritur me normë më të ulët prej 0% dhe normë të interesit të depozitit të disponueshëm njëditor të Bankës Qendrore Europiane, të reduktuar për 0,15 pikë përqindje (2023: norma e interesit të depozitit të disponueshëm njëditor të Bankës Qendrore Europiane varionte në interval prej 2% deri 4% në nivel vjetor).

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Banka Popullore nuk ka kërkesa në bazë të interesit të llogaritur për rezervën e detyrueshme të bankave në valuta të huaja.

²⁸ Në maj 2023 u miratua vendimi për deaktivim të ankandeve të depozitave në valutë të huaj nga bankat vendase.

²⁹ Vendim për rezervën e detyruar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/24.

35. Bonot e thesarit të Bankës Popullore

Në vitin 2024, në ankandet e bonove te thesarit zbatoheshte tender me vlerë të kufizuar dhe normë fikse të interesit. Të drejtën e pjesëmarrjes në ankandet e bonove te thesarit kanë bankat, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret³⁰.

Norma e interesit të bonove të thesarit në vitin 2024 varionte prej 6,30% deri 5,55% në nivel vjetor (2023: prej 4,75% deri 6,30% në nivel vjetor).

Më 31 dhjetor 2024, interesi i llogaritur i bonove të thesarit të Bankës Popullore arrin 19.838 mijë MKD (2023: 19.057 mijë MKD).

Fluksi monetar i bonove të thesarit të Bankës Popullore është si në vijim:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	9.946.097	9.450.579
Bonot e thesarit të Bankës Popullore, të hyrat	78.772.070	86.699.296
Bonot e thesarit të Bankës Popullore, të dalat	(79.390.000)	(86.764.000)
Diskont, flukse	616.691	560.222
Gjendja më 31 dhjetor	9.944.858	9.946.097

36. Detyrime në bazë të transaksioneve repo valutore

	2024	2023
Transaksionet repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në letra me vlerë	9.044.293	18.381.963
Transaksionet repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në ari	3.773.070	4.102.947
Gjithsej	12.817.363	22.484.910
Aktuale	12.817.363	22.484.910

Banka Popullore në vitin 2024 dhe 2023 ka kryer transaksione repo me banka të huaja me kolateral të siguruar në letra me vlerë të huaja dhe ari (shënimi 2D).

Vlera totale e tregut e kolateralit të dhënë arrin 12.887.961 mijë MKD, nga të cilat vlera e tregut e kolateralit të dhënë në ari arrin 3.843.217 mijë MKD, ndërsa vlera e tregut të kolateralit të dhënë në letra me vlerë të huaj arrin 9.044.744 mijë MKD (2023: vlera totale e tregut të kolateralit të dhënë arrin 4.017.161 mijë MKD, ndërsa vlera e tregut të kolateralit të dhënë në letra me vlerë të huaj arrin 18.407.260 mijë MKD).

³⁰ Vendim për bonot e thesarit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 245/24.

36. Kërkesat e bazuara në transaksionet-repo (vazhdon)

Detyrimet në bazë të transaksioneve repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në letra me vlerë më 31 dhjetor 2024 i përfshijnë detyrimet në bazë të interesit të llogaritur në vlerë prej 5.624 mijë MKD (2023: 11.228 mijë MKD), ndërsa detyrimet në bazë të transaksioneve repo në valutë të huaj me kolateral të dhënë në ari i përfshijnë në bazë të interesit të llogaritur prej 319 mijë MKD (2023: 682 mijë MKD).

37. Depozitat në denarë të shtetit

Banka Popullore kryen veprime depozitare për shtetin dhe për organet e administratës shtetërore, në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore.

	2024	2023
Llogaria e vetme e thesarit	26.510.462	24.753.036
Depozita tjera në denarë	1.241.408	1.043.885
Gjithsej	27.751.870	25.796.921
Aktuale	27.751.870	25.796.921

Banka Popullore paguan interes në depozitat në denarë të shtetit³¹.

Norma e interesit për depozitat në denarë të shtetit është përcaktuar në shumën e normës mujorë të ponderuar të interesit të bankave për depozitat njëditore për institucione jofinanciare pa klauzolë valutore, e cila në vitin 2024 varionte në interval prej 0,12% deri 0,20% në nivel vjetor (2023: prej 0,05% deri 0,20% në nivel vjetor).

Depozitat e shtetit e përfshijnë interesin e llogaritur me vlerë prej 930 mijë MKD (2023: 672 mijë MKD).

38. Depozitat valutore të shtetit

Në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore dhe Ligjin e Operacioneve Valutore, Banka Popullore është agjent i shtetit për kryerjen e qarkullimit pagesor me vende të huaja. Organet e pushtetit qendror dhe një pjese të fondeve publike i deponojnë të hyrat e tyre valutore te llogaria e Bankës Popullore, me kusht Ministria e Financave formalisht t'i autorizojë për hapjen e llogarisë së tillë. Më 31 dhjetor 2024, këto depozita arrijnë 35.731.243 mijë MKD (2023: 15.518.617 mijë MKD).

³¹ Në pajtim me Vendimin e llogaritjes dhe pagesës së interesit të depozitave të organeve të administratës shtetërore te Banka Popullore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 183/22, interesi paguhet për depozita pa afat të organeve të administratës shtetërore më së shumti deri në shumën e përcaktuar paraprakisht e cila për depozitat në denarë është 6.000.000 mijë MKD.

38. Depozita valutore të shtetit (vazhdon)

Banka Popullore paguan interes për depozitat valutore të shtetit³².

Norma e interesit për depozitat valutore të shtetit është përcaktuar në shumën e normës mujorë të ponderuar të interesit të bankave për depozitat valutore njëditore për institucione jofinanciare në euro, e cila në vitin 2024 varionte në interval prej 0,02% deri 0,06% në nivel vjetor (2023: prej 0,01% deri 0,02% në nivel vjetor).

39. Depozita të kufizuara

Depozitat e kufizuara kryesisht i përfshijnë mjetet valutore të deponentëve (shteti) të cilat presin realizimin e dërgesës jasht vendit dhe mjetet të deponentëve (shtetit) të cilët paraqesin mbulim prej 100% për akreditiv të hapur në llogarinë e tyre nga ana e Bankës Popullore. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita. Gjendja e këtyrë mjeteve më 31 dhjetor 2024 shënon 206.834 mijë MKD (2023: 208.273 mijë MKD).

40. Detyrime ndaj FMN-së

Detyrimet ndaj FMN-së i përbëjnë detyrimet në bazë të shpërndarjes kumulative neto, detyrimet në bazë të përdorimit të kredive nga FMN-ja dhe në llogari të shtetit dhe detyrimet në bazë të anëtarësimit dhe depozitave të FMN-së.

a) Detyrime në bazë të shpërndarjes së DST-së – në emër dhe llogari të shtetit

Me Vendim të Këshillit ekzekutiv të FMN-së nga 14 dhjetor 1992, në pajtim me Ligjin e Trashëgimisë Juridike të Republikës së Maqedonisë të antarësimit në FMN, shteti trashëgoi 5,4% nga detyrimi në bazë të shpërndarjes neto të DST-së së ish Jugosllavisë, në shumë prej 641.289 mijë MKD (8.379 mijë DST).

Me vendim të Bordit ekzekutiv të FMN-së nga 7 gusht 2009, shteti mori shpërndarje kumulative neto të DST-së në shumë prej 3.909.279 mijë MKD (51.076 mijë DST). Me hyrjen në fuqi të amandamentit të katërt të Statutit të FMN-së më 10 gusht 2009, ndërsa në bazë të Vendimit të miratuar nga Bordi ekzekutiv të FMN-së nga viti 1997, shteti mori shpërndarje kumulative neto të posaçme të DST-së në shumë prej 471.623 mijë MKD (6.162 mijë DST).

³² Në pajtim me Vendimin e llogaritjes dhe pagesës së interesit të depozitave të organeve të administratës shtetërore të Banka Popullore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 183/22, interesi paguhet për depozita pa afat të organeve të administratës shtetërore më së shumti deri në shumën e përcaktuar paraprakisht e cila për depozitat në denarë është 100.000 mijë EUR.

40. Detyrime ndaj FMN-së (vazhdon)**a) Detyrime në bazë të shpërndarjes së DST-së – në emër dhe llogari të shtetit (vazhdon)**

Me vendim të Këshillit ekzekutiv të FMN-së nga 2 gusht 2021, shteti mori shpërndarje kumulative neto të DST-së në shumë prej 10.292.173 mijë MKD (134.471 mijë DST). Miratimi i shpërndarjes së fondeve është për vendet anëtare në FMN të cilat janë pjesëmarrëse në Departamentin për DST proporcionalisht me kuotimet e tyre ekzistuese në FMN dhe ka për qëllim të sigurojë likuiditet më të madh në sistemin global ekonomik nëpërmjet mbështetjes së rezervave valutore të vendeve anëtare në FMN.

Detyrimi total i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpërndarjen e DST-së në fund të vitit 2024 arrin 15.314.364 mijë MKD ose 200.088 mijë (2023: 14.912.427 mijë MKD, ose 200.088 mijë DST).

Sipas Statutit të FMN-së, detyrimi për shpërndarjen e DST-së maturohet për pagim vetëm në rastin dhe në shumën e shpërndarjes së DST-së së anuluar, e cila kërkon vendim nga Këshilli i guvernatorëve të FMN-së, me shumicë të votave prej 85%, ose në rast të anulimit të pjesëmarrjes në Departamentin e DST-së në kuadër të FMN-së.

Banka Popullore paguan interes në shumën totale të detyrimit në bazë të shpërndarjes së DST-së (200.088 mijë DST), e llogaritur sipas normës bazë të interesit të FMN-së. Banka Popullore rimbursin interesin e paguar të detyrimit në bazë të shpërndarjes së DST-së nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

b) Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja, në emër dhe llogari të shtetit

	Shënim	2024	2023
Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja në emër dhe llogari të shtetit (Linja kreditore PLL)	23	15.673.045	6.327.952
Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja në emër dhe llogari të shtetit (Linja kreditore RFI)	23	2.702.183	7.909.940
Gjithsej		18.375.228	14.237.892
Aktuale		2.804.317	5.349.900
Joaktuale		15.570.911	8.887.992

40. Detyrime ndaj FMN-së (vazhdon)

b) Detyrime në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja, në emër dhe llogari të shtetit (vazhdon)

Në prill 2020, shteti ka marrë hua nga FMN-ja me instrumentin për financim të shpejtë (PLL) në shumë prej 140.300 mijë DST (100% nga kuotimi), i synuar për mbështetje të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme³³. Afati për shlyerjen e shumës së tërhequr nga instrumenti është tre vite dhe tre muaj deri në pesë vite nga tërheqja.

Shlyerja e shumës së tërhequr nga instrumenti, i cili do të kryhet në tetë këste të barabarta tremujore, filloi në korrik 2023. Deri 31 dhjetor 2024 janë shlyer gjashtë këste nga instrumenti për financim të shpejtë (RFI) në shumë totale prej 105.225 mijë DST.

Në nëntor 2022, shtetit iu miratuan fonde nga Linja kreditore e maturisë dhe likuiditetit (PLL) nga FMN-ja, në shumë prej 406.870 mijë DST (290% nga kuotimi), të destinuara për mbështetje të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut³⁴, nga të cilat shteti tërhoqi shumën prej 84.180 mijë DST (60% nga kuotimi). Në janar 2024, shteti tërhoqi pjesë të dytë të Linjës kreditore të maturitetit dhe likuiditetit (85% nga kuotimi) në shumë prej 119.260 mijë DST. Shlyerja e secilës shumë të tërhequr nga linja kreditore do të bëhet në tetë këste të barabarta tremujore, në afat prej tre vitesh dhe tre muajve deri në pesë vite nga tërheqja. Shlyerja e këstit të parë, që rrjedh nga shuma e tërhequr e mjeteve nga linja kreditore paraprake dhe e likuiditetit në vitin 2022, do të fillojë në shkurt 2026. Pagesa e këstit të parë për shumën e mjeteve të tërhequra nga linja kreditore në janar 2024 do të fillojë në prill 2027.

Detyrimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja në fund të vitit 2024 arrin 18.255.485 mijë MKD ose 238.515 mijë DST (2023: 14.116.222 mijë MKD, ose 189,405 mijë DST).

Shumave të tërhequra nga instrumentet iu zbatohet norma e interesit e përcaktuar sipas rregullave të FMN-së, dhe në pajtim me kushtet e financimit të cilat vlejnë për linjat kreditore.

Interesi i llogaritur në bazë të kredive të përdorura nga FMN-ja, në emër dhe në llogari të shtetit, më 31 dhjetor 2024 është 119.743 mijë MKD (2023: 121.670 mijë MKD).

³³ Lidhur me Dekretin me fuqi juridike për borxhin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të FMN-ja për mbështetje financiare nga instrumente për financim të shpejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 100/20.

³⁴ Në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për debitim të Republikës së Maqedonisë së Veriut të FMN-ja për Linjë të maturitetit për likuiditet, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 246/22.

40. Detyrime ndaj FMN-së (vazhdon)**c) Detyrime në bazë të anëtarësimit dhe depozitave**

	2024	2023
Detyrime në bazë të kambialeve të emetuara për anëtarësim në FMN.	10.579.694	10.502.049
Detyrime në bazë të llogarisë 1	26.516	26.321
Detyrime në bazë të llogarisë 2	153	152
Gjithsej	10.606.363	10.528.522
Aktuale	10.606.363	10.528.522

Në shkurt 2016, hyri në fuqi Rezoluta nr. 66-2 për Revizionin e katërmbëdhjetë të përgjithshëm të kuotave dhe Reforma e Këshillit Ekzekutiv, të miratuar më 15 dhjetor 2010 nga Këshilli i Guvernatorëve të FMN-së, me të cilën propozoi rritjen e kuotave të secilit prej vendeve anëtare të FMN-së. Në pajtim me Rezolutën, kuota e vendit për anëtarësim në FMN në vitin 2016 u rrit prej 68.900 mijë DST ekzistuese, në 140.300 mijë DST. Për anëtarësim te FMN-ja, Banka Popullore, si agjent fiskal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka emetuar kambiale (shënimi 24).

41. Depozita të tjera

	2024	2023
Detyrime në bazë të depozitave në denarë ndaj subjekteve tjera vendase	293.485	3.264.712
Detyrime në bazë të depozitave në denarë ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare (IBRD ³⁵ , IDA ³⁶ dhe MIGA ³⁷)	8.788	6.788
Gjithsej	302.273	3.271.500
Aktuale	302.273	3.271.500

Detyrime në bazë të depozitave në denarë ndaj subjekteve tjera vendase i përfshijnë: llogaria e Fondit rezervë për garanci të KIBS-it, llogaritë e klientëve të shoqërive të brokerimit dhe llogarive të Depozitarit qendror për letra me vlerë. Llogaritë e klientëve të shoqërive të brokerëve dhe llogarive të Depozitarit qendror për letra me vlerë shërbejnë për shlyerjen e transaksioneve për operacione me letra me vlerë. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita.

Llogaritë në denarë të institucioneve financiare ndërkombëtare janë deponuar te Banka Popullore. Banka Popullore nuk paguan interes për këto depozita.

³⁵ Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe Zhvillimit (International Bank for Reconstruction and Development) – IBRD.

³⁶ Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (International Development Association) – IDA.

³⁷ Agjencia e Garantimit të Investimeve Multilaterale (Multilateral Investment Guarantee Agency) – MIGA.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**Shënime në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijëra MKD, nëse nuk është e theksuar ndryshe)***42. Rezerva e veçantë**

	2024	2023
Rezerva e veçantë për detyrimet e mundshme në bazë të kontesteve gjyqësore me persona fizik dhe juridik	65	373
Gjithsej	65	373

Rezerva e veçantë për detyrimet e mundshme në bazë të kontesteve gjyqësore i referohet shumës së kryegjës dhe interesit për të cilin Banka Popullore pret t'u paguajë personave fizik dhe juridik që kanë ngritur padi kundër Bankës Popullore, pas përfundimit të procedurave juridike.

Zhvillimet e rezervës së veçantë për detyrimet e mundshme në bazë të kontesteve gjyqësore janë shfaqur në vazhdim:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	373	344
Shpërndarja e rezervës së veçantë për detyrimet e mundshme nga proceset gjyqësore (shënimi 15)	31	29
Lëshimi i rezervës së veçantë për detyrimet e mundshme nga proceset gjyqësore (shënimi 15)	(339)	-
Gjendja më 31 dhjetor	65	373

43. Detyrime të tjera

	2024	2023
Detyrime në bazë të fitimit të shpërndarë	2.898.258	109.779
Të deponuara në bazë të fondeve të konfiskuara dhe të depozituara	271.928	277.519
Detyrime nga falimentimi i BNT-së	144.895	144.895
Interesi i llogaritur në valutë të huaj në bazë të marrëveshjet e lidhura	85.137	103.611
Detyrime në bazë të dobive afatgjata të punonjësve	42.915	35.658
Detyrime ndaj furnizuesëve dhe detyrime tjera	26.988	78.822
Kundërpozicioni i monedhave jubilarë	7.617	5.986
Detyrime në bazë të qirave	5.326	4.174
Të hyrat e shtyra	2.714	3.365
Detyrime në bazë të tatimeve	832	1.616
Gjithsej	3.486.610	765.425

43. Detyrime të tjera (vazhdon)

Detyrimet në bazë të fitimit të shpërndarë në vitin 2024 në shumë prej 2.898.258 mijë MKD (2023: 109.779 mijë MKD) i referohen fitimit të shpërndarë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (shënimi 1 dhe shënimi 44) dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit të Bankës Popullore. Shpërndarjen e fitimit neto e miraton Këshilli i Bankës Popullore.

Detyrimet në bazë të mjeteve të deponuara në bazë të mjeteve efektive të konfiskuara dhe emetimeve të deponuara i referohen mjeteve të deponuara valutore të cilave organet kompetente shtetërore ua sekuestruan si masë detyruese personave juridik dhe fizik si masë obligative dhe kundër të cilave kanë ngritur padi në gjykatat kompetente. Varësisht nga aktvendimi gjyqësor, këto valuta të huaja i kthehen personit nga i cili janë sekuestruar, ose në kundërvlerë në denarë arkëtohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Banka Popullore nuk paguan interes për këto mjete.

Detyrimet që rrjedhin nga falimentimi i Bankës për Tregti të Jashtme (BTJ) i referohen detyrimeve të trashëguara të Bankës Popullore në bazë të kursimeve të qytetarëve të gjetura në kohën e shpalljes së falimentimit të BTJ-së në vitin 1995, në shumë prej 292.442 mijë MKD. Për shlyerje të këtyre detyrimeve, Bankës Popullore iu siguroa patundshmëri nga pasuria e falimentimit, të cilën menjëherë, pa kompensim, ia dorëzoi Qeverisë.

Interesat e llogaritura në valutë të huaj në bazë të marrëveshjeve të lidhura i referohen interesit të llogaritur në bazë të shpërndarjes neto kumulative nga FMN-ja, në emër dhe në llogari të shtetit.

Detyrimet në bazë të përfitimeve afatgjata të punonjësve, përveç kontributeve të sigurimit pensional, janë të njejta me shumën e përfitimeve të ardhshme të cilat i realizojnë punonjësit në bazë të mundit të tyre në periudhat e tashme dhe të kaluara, i zbritur deri në vlerën kontabël duke aplikuar normë vjetore interesi të ponderuar prej 5,40% për obligacionet afatgjata të emetuara nga shteti në vitin 2024 me afat të maturimit prej 5 dhe mbi 5 vite (2023: norma e ponderuar e interesit prej 5,95% e obligacioneve afatgjata të emetuara nga shteti në vitin 2023 me afat të maturimit prej 5 dhe mbi 5 vite).

44. Kapitali dhe rezervat*Kapitali*

Kapitali i Bankës Popullore i definuar me Ligjin e Bankës Popullore më 31 dhjetor 2024 shënon 1.289.789 mijë MKD (viti 2023: 1.289.789 mijë MKD).

Rezerva speciale dhe të përgjithshme

	2024	2023
Rezerva të përgjithshme	1.200.434	688.977
Rezerva speciale	1.697.826	1.697.826

Rezerva e përgjithshme përdoret vetëm për mbulimin e humbjeve të Bankës Popullore.

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit të Bankës Popullore nga 24 janari 2025³⁸, më 7 shkurt 2025 në rezervat e përgjithshme u transferuan fonde në rezervat e veçanta në shumë prej 1.697.826 mijë MKD, me çka rezervat e përgjithshme arritën shumën prej 2.386.803 mijë MKD dhe tejkaluan nivelin e kapitalit bazë të përshkruar me Ligjin i Bankës Popullore.

Me ndryshimet e Ligjit të Bankës Popullore nga 24 janari 2025³⁹, u bë ndryshimi edhe në mënyrën e shpërndarjes së fitimit për shpërndarje, kështu që 30% i fitimit për shpërndarje, shpërndahet në rezervat e përgjithshme të Bankës Popullore deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë, pra shpërndahen 15% pas arritjes, dhe pjesa tjetër shpërndahet për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për vitin 2024, pas përshtatjes së rezultatit financiar të Bankës Popullore të përcaktuar sipas SMTK-së për të hyrat dhe daljet e përcaktuara nga ndryshimet e kursit dhe të çmimeve (2.559.848 mijë MKD) dhe shtesën e të hyrave të përcaktuara në vitin 2024 nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë për të cilat vitet paraprake janë ndarë rezervat e revalorizuara (849.867 mijë MKD), u përcaktua fitimit për shpërndarje në shumë prej 3.409.715 mijë MKD (viti 2023, 1.219.769 mijë MKD⁴⁰). Më 31 dhjetor 2024, nga rezultati i përcaktuar për shpërndarje për vitin 2024, në rezervat e përgjithshme është shpërndarë shumë prej 511.457 mijë MKD (2023: 256.151 mijë MKD).

³⁸ Në pajtim me nenin 4 nga Ligji i Ndryshimit të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 16/25), shumat e akumuluar e rezervave të veçanta transferohet në rezervat e përgjithshme në afat prej 30 ditëve nga hyrja e ligjit në fuqi.

³⁹ Neni 2 nga Ligji i Ndryshimit të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.16/25).

⁴⁰ Në përputhje me dispozitat nga Ligji i Bankës Popullore të cilat ishin në fuqi për vitin që mbaroi më 31 dhjetor 2023, shpenzimet e përcaktuara të rivlerësimit u mbuluan nga llogaritë përkatëse të rezervës së rivlerësimit derisa gjendja e këtyre llogarive nuk u zvogëlua në zero, dhe më pas nga fitimi i realizuar në vitin aktual, nga llogaria për rezervë të përgjithshme dhe nga kapitali.

44. Kapitali dhe rezervat (vazhdon)*Rezervat e revalorizuara*

	2024	2023
Rezervat e revalorizuara nga ndryshime e çmimit dhe kursit të arit	20.729.039	12.096.431
Rezervat e revalorizuara nga diferenat e këmbimit	(62.323)	-
Rezervat e revalorizuara të ndryshimeve të çmimit të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit	2.140.513	1.605.706
Rezervat e revalorizuara të ndryshimeve të çmimit të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	408.114	221.596
Rezervat e revalorizuara për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	7.888	1.132
Rezervat e revalorizuara nga ndryshimet e çmimeve nga instrumentet derivative financiare	59.828	-
Rezervat e revalorizuara të ndryshimeve të çmimit të letrave me vlerë pronësie të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës	784	681
Rezervat e revalorizuara të ndryshimeve në vlerën objektive të veprave artistike, fondit të bibliotekës dhe lëndëve të muzeut	4.137	4.127
Gjithsej	23.287.980	13.929.673

Rezervat e revalorizuara përfaqësojnë akumulimin e kursit pozitiv neto të parealizuar dhe ndryshimet e çmimeve nga rivlersimet periodike të kursit të këmbimit dhe çmimeve të mejteve dhe detyrimeve në valutë të huaj, si dhe rezervat e akumuluar për humbjen e pritur kreditore të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës, që përdoren si rezervë për mbrojtje nga tendencat e ardhshme negative në zhvillimin e ndryshimeve të kursit dhe çmimit, si dhe nga humbjen e ardhshme të mundshme të kredive të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës.

Rezerva e revalorizuar nga ndryshimet e çmimit dhe kursit të arit në vitin 2024 është rritur në shumë prej 8.632.608 mijë MKD, si rezultat i shpërndarjes neto të diferencave pozitive neto të parealizuar të çmimit dhe kursit të arit (2023: Rritje prej 2.279.169 mijë denarë, si rezultat i diferencave pozitive neto të parealizuar në çmimin e arit dhe në kursin e këmbimit).

Rezerva e rivlerësuar nga ndryshimet e kursit nga mjetet dhe detyrimet e valutë të huaj, nga 31 dhjetori 2024, është negative dhe shënon 62.323 mijë MKD (2023: Zero MKD si rezultat i mbulimit të diverencave neto të kursit të parealizueshme negative për 2023, në vlerë prej 79.669 mijë MKD).

44. Kapitali dhe rezervat (vazhdon)*Rezervat e revalorizuara (vazhdon)*

Rezerva e revalorizuar e ndryshimeve të çmimit të letrave me vlerë të borxhit të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit në vitin 2024 është rrit në bazë neto në shumë prej 534.807 mijë MKD, nga të cilat:

- Neto-rritje prej 1.384.674 mijë MKD, si rezultat i ndryshimeve neto pozitive të çmimit të përealizueshme të letrave me vlerë të matura me vlerë objektive përmes bilancit të suksesit (2023: ndryshimet neto pozitive të çmimit të përealizuara të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet bilancit të suksesit në shumë totale prej 1.605.706 mijë MKD) dhe
- Ulje prej 849.867 mijë MKD, si rezultat i ndryshimit të çmimeve të realizuara të letrave me vlerë, të cilat ju shtuan fitimit për shpërndarje për vitin 2024 (2023: ndryshime të realizuara të çmimit të letrave me vlerë në shumë totale prej 32.296 mijë MKD).

Rezerva e revalorizuar nga ndryshimet e çmimeve nga instrumentet derivate financiare, më 31 dhjetor 2024, shënon 59.858 mijë MKD si rezultat i ndryshimeve neto pozitive të përealizueshme të çmimeve nga transaksionet e këmbimit valutor të mbuluar.

Rezerva e revalorizuar e ndryshimeve të çmimit të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës dhe rezervës për humbjen e pritshme kreditore në vitin 2024 është rritur në bazë neto në shumë prej 193.274 mijë MKD, nga të cilat:

- Neto-rritje prej 187.890 mijë MKD, si rezultat i ndryshimeve neto pozitive të çmimit të përealizueshme të letrave me vlerë të matura me vlerë objektive përmes fitimit të mbetur gjithpërfshirës (2023: ndryshimet neto pozitive të çmimit të përealizuara të letrave me vlerë të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithpërfshirës në shumë totale prej 221.596 mijë MKD) dhe
- Neto-rritje prej 6.756 mijë MKD si rezultat i rezervës së veçuar për humbjen e pritshme kreditore për letrat me vlerë të matura sipas vlerës objektive përmes fitimit të mbetur gjithpërfshirës (2023: Rezerva e ndarë për humbjen e pritshme kreditore për letrat me vlerë në vlerë prej 1.132 mijë MKD); dhe
- Rënie prej 1.372 mijë MKD, si rezultat i ndryshimeve të realizuara të çmimeve të letrave me vlerë në vlerë objektive përmes fitimit të mbetur gjithpërfshirës.

44. Kapitali dhe rezervat (vazhdon)*Rezervat e revalorizuara (vazhdon)*

Rezerva e revalorizuar nga ndryshimet e çmimeve të letrave me vlerë pronësie të matura sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës, në vitin 2024 është rritur për 103 mijë MKD si rezultat i ndryshimeve neto pozitive të përealizuara të çmimeve në vlerën objektive të letrave me vlerë pronësie të matura nëpërmjet fitimit të mbetur gjithëpërfshirës (viti 2023: 179 mijë MKD).

Më 31 dhjetor 2024, Rezerva e revalorizuar e veprave artistike, fondit të bibliotekës dhe lëndëve të muzeut shënon 4.137 mijë MKD (viti 2023: 4.127 mijë MKD). Rritja e rezervave të revalorizuara në vitin 2024 në shumë prej 10 mijë MKD është në bazë të donacioneve të librave në fondin e bibliotekës së Bankës Popullore (viti 2023: rritje në shumë prej 42 mijë MKD).

45. Paratë dhe ekuivalentët e saj

	2024	2023
Paratë e huaja efektive (shënimi 16)	685.130	821.607
Depozita në valutë të huaj (shënimi 17)	52.676.876	107.859.919
Të drejtat speciale të tërheqjes (shënimi 21)	71.116	13.249
Gjithsej	53.433.122	108.694.775

46. Detyrimet e mundshme dhe të ndërmarra**a) Paditë**

Aktualisht zhvillohen disa procedura gjyqësore kundër Bankës Popullore të cilat dalin nga puna aktuale. Më 31 dhjetor 2024, paditë vlerësohen në shumë prej 447.132 mijë MKD (viti 2023: 447.070 mijë MKD). Banka Popullore i kundërshton këto padi dhe në bazë të këshillave juridike, vlerëson se nuk do ketë humbje të konsiderueshme materiale.

Në vitin 2024, Banka Popullore ndau rezervë të posaçme në vlerë prej 31 mijë MKD për detyrimet e mundshme mbi bazën e proceseve gjyqësore për të cilat pret që ndoshta do të duhet t'i paguajë detyrimet. Nga ana tjetër, në vitin 2024 Banka Popullore lëshoi rezervë të veçantë për detyrimet e mundshme në vlerë prej 339 mijë MKD për procese gjyqësore të cilët mbaruan në favor të Bankës Popullore (viti 2023: ndarja e rezervës së veçantë në shumë prej 29 mijë MKD për proceset gjyqësore) (shënimet 15 dhe 42).

Për pjesën tjetër të procedurave gjyqësore, Banka Popullore nuk ka ndarë asnjë rezervë, sepse në bazë të mendimit dhe këshillave juridike, udhëheqësia beson se rezultati përfundimtar do të jetë në favor të Bankës Popullore dhe se nuk do të ketë humbje materiale në raport të procedurave gjyqësore.

46. Detyrimet e mundshme dhe të ndërmarra (vazhdon)

b) Detyrimet e ndërmarra

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Banka Popullore nuk ka marrë obligime të rëndësishme në bazë të kontratave të lidhura për investime në objekte dhe pajisje ndërtimore.

47. Transaksionet me subjektet e ndërlidhura

Banka Popullore ka transaksione me subjektet e lidhura, me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me të gjithë anëtarët e Këshillit. Transaksionet dhe gjendjet me subjektet e lidhura shfaqen në shënimet 5, 6, 13, 23, 24, 37, 38, 39 dhe 43.

48. Ngjarjet pas datës së Raportit të gjendjes financiare

Pas datës së përgaditjes së Raportit për gjendjen financiare, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje me rëndësi materiale që do të shkaktonte korrigjim të raporteve financiare dhe as ngjarje që duhet të publikohen në raportet financiare.